"the use of computers in the classroom can be distracting, because the students might want to play games or connect to the internet during the class. Teachers would not find it easy to keep those students focused on the class. "

The problem mentioned here is two-sided. Namely, it might stem from the lack of students' seriousness or from the teacher being indifferent to computer-based lessons. What should be kept in mind is that the inclusion of computers in our lessons must be purposeful. If this step lacks purpose and, especially, if the activity is planned to take the whole lesson - then this approach is predetermined to failure.

The second question raised in the interview was about the connection between CALL and one's language development. Students' answers on this question backed up the studies which showed the role of CALL and its impact on their progress in different language domains. Sullivan & Pratt (1996) give an example of a group who was subjected to a CALL experiment for the whole term. In their study computer-mediated debates and talks were more fruitful for the development of students' writing skills than being involved in oral discussions. The following lines will provide us with more insight about the impact of CALL. Interviewee *UH* stated that: "I do believe it can be quite useful in the long run. Learning in a school environment with a teacher present has benefits, and adding a system that has, in comparison to textbooks, many more readily available resources for just

about any topic could massively improve education. I am a person who believes that you cannot learn a language strictly through textbooks, as there is only so much information that they can cover inside them, and they mostly stick to basics. With an infinite source of knowledge like the internet, and a teacher's guidance to which resources are worthwhile and useful for proper learning, language development in schools could reach a whole different level. "

What is interesting to note here is the negative attitude of student NB about the CALL. He was again skeptical about its influence on students' progress claiming:

"... the best way to learn a language is through direct communication during the class. Computers can be used to write down notes, but not for language learning. "

On no condition, claims NB, should the computers assert primacy to teachers or peer-to-peer relationship nor communication. This remark is understandable and can also be corroborated by the attitudes of experienced scholars and researchers. For instance, Warschauer (1998) in his paper on computers and language learning insists on teachers as facilitators.

The following paragraph part presents the answers to the comparison of CALL and book-oriented lessons and their acceptance in the classroom. Students were asked what they see as a more beneficial option. Analysis will start with our participant *NB* who again strongly disapproved of the idea of CALL. Throughout his answers we see that his overall attitude towards computer-mediated lessons is negative, not only particular segments of it. What he gives as a reason is that:

"during the pandemic and online school for example I did not feel engaged at all, and did not understand most of the lessons we did in any foreign language we learned. "

Three participants stated that success of language instruction depends on the symbiosis of CALL and books; each way has its own positive and negative sides and can be neither absolutely accepted nor discarded. The reason why the student considers computers as essential is that:

"textbooks mostly focus on theoretical knowledge and don't have enough space to cover the things that I believe truly allow a person to know a language, such as a wider vocabulary and opportunities to converse with people who know the language better than I do."

In this particular case course books are primarily seen as an inhibitor of success. Another first grader sees both options as beneficial if implemented in the proper way, even though she would rather rely more on CALL lessons. Not only do we see computers as a tool which facilitates learning, but it also has a strong impact on student perceptions and motivation. According to our participant *MAA* from Botswana:

"book work takes time and energy leaving the student fatigued and unmotivated; the use of computers would reduce these negative effects. "

Majority of the students mostly agree with the view that CALL will be the integral part of each school's curriculum in the future. The last item students commented on was if CALL motivates learners toward autonomous or self-directed learning. They were asked about their views on CALL and if it helps students gain independence and autonomy while studying, *UM* clarifies that:

"...it does. Technology in itself presents a more wide array of learning chances, and with the majority of content for general interests that young people have such as movies and TV shows also being in English and readily available, I believe that it gives a strong initiation for us to learn in our free time, especially once we're already acquainted with the usage of devices in our education."

All other students unanimously agreed with the power of CALL to make students autonomous learners with, of course, adequate guidance from an expert/teacher. *MB* was optimistic and again gave advantage to CALL in this regard stating that:

" ... it would motivate learners towards autonomous learning...currently, a significant number of students do not feel challenged by school courses and technology would be the simplest and most accessible way to acquire said challenge."

CALL could be more beneficial for students in the long run simply because of its adaptability. All the interviewees are unanimous about its prosperous future to an extent when it completely replaces books. The reasons of this optimism that they provide are:

- its popularity in everyday life
- exponentially growing dependence on computers in all spheres
- easy access to many different and entertaining learning materials
- an easier way to learn a language since there is no big effort required to progress

Book-oriented lessons use materials that are prepared for the use of student body as a whole. However, these materials cannot be optimal way of learning for every student, every class, or even every generation of students.

CONCLUSION

The paper reveals visible connection between all participants in their attitudes regardless of their gender, class or age. It focuses on the results of interviews conducted with high school students about their interest and attitudes to computer-mediated language learning. The majority of students expressed similar or identical views about the CALL and its implementation in language classrooms. It should be noted that students' negative views of language acquisition in general will also negatively affect the acceptance of technology in classroom. Therefore, educators are to be instructed how to "manipulate" and elicit positive attitudes from students to successfully implement the concept of CALL.

The paper also provides some useful suggestions about the confrontational interests of teachers and students in terms of CALL. It has been shown by the findings that teachers' negative experiences also affect the idea of computer-mediated classes. The experiences can originate from their personal attitudes to external factors such as bad facilities, lack of interest or administrative support. To resolve some of the issues teachers must seek solutions throughout their professional development programs, seminars and symposiums which will help them handle the situation and apply the content

they have acquired into classroom practice. On the other hand, support and incentive from school administration should also be involved during this process. Educator practice programs are crucial in supplying the current and future teachers with necessary skills which will help them meet the needs of the modern world.

When it comes to students, their informal or “home” education and preparation about CALL plays an important role in the future. It is almost impossible to find a kid with no access to computer or internet nowadays. Even though some students’ computer-related aspects, such as typing speed, have little or no impact on how motivated they were, their practical knowledge concerning how to effectively use computers has a considerable impact on their motivating views (Karakas, 2011). The results in this paper are encouraging; they deny the statements of all those teachers who claim that schools in Bosnia and Herzegovina are not adequately equipped and that CALL is just an idea which should be revived.

One of the equally important pillars CALL rests on is mutual trust between all participants in the process. With their positive attitudes, dedication and awareness of how beneficial computer-mediated instruction can be and that the future modern education depends on computer assisted language learning rather than on a chalk and board lessons, the implementation computer-aided instruction will go effortlessly.

REFERENCES

- Bermeo, E. (2014). South Korea's successful education system: lessons and policy implications in Peru. *Korean Social Science Journal*, DOI: 10.1007/s40483-014-0019-0.
- Costley, Kevin. (2014). The Positive Effects of Technology on Teaching and Student Learning. Online submission. ERIC, ED554557.
- Dahlstrom, E., Bischel, J. (2014). *ECAR study of Undergraduate students and Information Technology*. Research report. Louisville, CO: ECAR.
- De Bruyckere, P., P.A., Kirschner & Hulshof C.D. (2016). Technology in education; what teachers should know. *American Educator*, ISSN-0148-432X.
- Delibegović-Džanić, N., & Hasanspahić, A. (2020). *Computer assisted language learning in English language classrooms in Bosnia and Herzegovina*. *Explorations in English Language and Linguistics*, 8.1 (2020): 14-46.
- Domjahn, T. M. (2013). What (if anything) can developing countries learn from South Korea? *Asian Culture and History*, 5(2), 16–24.
- Economist Intelligence Unit, EUI. (2012). *The learning curve: Lessons in country performance in education*, 2012. London: Pearson.
- Glennan, T. K., & Melmed, A. (1996). *Fostering the use of educational technology: Elements of a national strategy*. Santa Monica, CA: RAND.
- Hanson-Smith, E. (1997). *Technology in the classroom: Practice and promise in the 21st century*. TESOL Professional Papers Virginia, USA: Teachers of English to speakers of other languages.
- Hsu, W.K.K., Huang, S.H.S., 2006. Determinants of computer self-efficacy - an examination of learning motivations and learning environments. *J. Educ. Comput. Res.* 35 (3), 245–265.
- Karakas, Ali. (2011). *Motivational attitudes of ELT students towards using computers for writing and communication*. *Teaching English with Technology*, 11(3), 37-53.

- Kesler, G. (2005). *Computer assisted language learning within masters programs for teachers of English to speakers of other languages*. The faculty of the College of Education of Ohio University.
- Kozma, B. (2002). *Comparative analysis of policies for ICT in education*. Center for technology in learning, SRI International, Menlo Park, CA, USA.
- Lamb, M., Arisandy, F. E. (2020). *The Impact of Online Use of English on Motivation to Learn*. Computer Assisted Language Learning, 33 (1-2). pp. 85-108. ISSN 0958-8221.
- Levine, T., Donitsa-Schmidt, S., 1998. Computer use, confidence, attitudes, and knowledge: a causal analysis. *Comput. Hum. Behav.* 14 (1), 125–146.
- Li, Li. (2017). *New technologies and language learning*. Calico journal (online) ISSN 2056–9017. London, England.
- Mann, D., & Shafer, E. (1997). *Technology and achievement*. The American School Board Journal.
- Okonkwo, U. (2011). *Computer Assisted Language Learning (CALL) Software: Evaluation of its Influence in a Language Learning Process*. Vol.12 No.1.
- Pamuk, S. (2012). Understanding preservice teachers' technology use through TPACK framework. *Journal of Computer Assisted Learning*, 28(5), 425-439.
- Park, C.N., & Son, J.B. (2009). *Implementing Computer-Assisted Language Learning in the EFL Classroom: Teachers' Perceptions and Perspectives*. *International Journal of Pedagogies and Learning*, 5(2).
- Partovi, T., Razavi, M.R., 2019. The effect of game-based learning on academic achievement motivation of elementary school students. *Learn. Motiv.* 68 (August), 101592.
- Pelavin Research Institute (1997). *Investing in school technology*. Thomas Jefferson Street, N.W., Suite 400 Washington, D.C. 20010.
- Ross, S., Moeller, E. 1996. Multimedia and hypermedia CBI. *Journal of Business and Technical Communication*, 10, 428-461.

Russel, G., Finger, G., & Russel, N. (2000). Information technology skills of Australian teachers: Implications for teacher education. *Journal of Information Technology for Teacher Education*, 9(2), 149-166.

Saldaña, J. (2009). *The coding manual for qualitative researchers*. Sage Publication.

Sanacore, J. (2008, September 1). Turning Reluctant Learners into Inspired Learners. *Clearing House: A Journal of Educational Strategies, Issues and Ideas*, 82(1), 40-44.

Singh, X.P. (2016). *The history and the current status of Computer-assisted language learning*. Dept. of English, V.O. Chidambaram College, Tuticorin.

Sullivan, N., Prat, Ellen. (1996). *A comparative study of two ESL writing environments: A computer-assisted classroom and a traditional oral classroom*. Elsevier, Volume 24, Issue 4.

Thorne, S., & Reinhardt, J. (2008). "Bridging activities," new media literacies, and advanced foreign language proficiency. . *CALICO Journal*, 25, 558-572.

Tsai, Hsien-Chang. (2015). A Senior Teacher's Implementation of Technology Integration. *International Education Studies*; Vol. 8, No. 6; 2015 ISSN 1913-9020 E-ISSN 1913-9039.

Warschauer, M. (1996). Motivational aspects of using computers for writing and communication. In M. Warschauer (Ed.), *Telecollaboration in foreign language learning: Proceedings of the Hawai'i symposium* (Technical Report # 12; pp. 29-46).

Warschauer, M., & Healey, D. (1998). Computers and language learning: An overview. *Language Teaching*, 31, 57-71.

Zhang, S. (2011). Attitudes of ESL students toward the use of computer-assisted language learning (CALL) in a University in China.

NDIHMESE REALISTE NË FORCIMIN E IDENTITETIT KULTUROR FETAR

Abstrakt

Kthimi (shqipërimi) i pjesshëm i *Kuranit* nga bashkatdhetari i krishterë Ilo Mitkë Qafëzezi, ndihmoi në ngjizjen e ndërgjegjes kombëtare. Punimi luan rol në zbulimin sesa dhe sesi kjo veprimtari kulturore mundi të tejkalonte të pamundurën zakonore, e cila pengonte sjelljen në gjuhën shqipe të *Librit të Shenjtë*. Komunikimi i vendosur mes komuniteteve fetare në Shqipëri mbështeti bindjen e dijetarit autodidakt se veprat e shkruara do të ndihmonin në forcimin e kujtesës kolektive. Njëherazi shkrimi shfaq nderimin për humanistin, i cili guxoi të sjellë në shqipe nga anglishtja disa sure të *Kuranit*. Kontributi i dhënë nga anëtari themelues i Akademisë Albanologjike Xaverjane për forcimin e ‘vëllazërimit fetar’, e letrarizoi kujtesën kolektive. Studiuesi e pranon te parathënia e botimit të vitit 1921 sesa rezultat kishte dhënë sprova e pamundur. Në të dëshmohet shkaku nxitës jo vetëm fetar apo filologjik: “I shtyrë prej dëshirës që, tani pak-së-paku, është koha të dihet se cila është ajo ‘cipë qepe’ misterioze që i ndan fetarisht shqiptarët Muhamedanë nga vëllëzërit e tyre të Krishterë, po jap të përkthyer shqip *Kuránin*, nga gjuha angleze” (*Kura`ni Këndimi*, 1921: 3) Pjesë e identitetit kombëtar bashkë me gjuhën shqipe është edhe kultura shqiptare, prandaj antropologu u rrek të sjellë në gjuhën shqipe vetëm fragmente të librit të shenjtë për myslimanët, sepse *Bibla* ishte sjellë në gjuhën shqipe rreth gjysmë shekulli më parë. Përkushtimi vizionar i autorit ndihmoi për forcimin e identitetit fetar mysliman, si pjesë e atij kombëtar. Si përfundim duhet thënë se realizmi i kësaj ndërmarrjeje shkencore dhe kulturore përkon me kohën patriotike, që ai e ndiente se ishte vazhde e ‘ditëvet besëprizrënase’. I. M. Qafëzezi dëshmon nëpërmjet këtij akti letrar realist edhe realizimin e misionit vetjak në vendin e duhur, që erdhi pas kësaj qasjeje të shenjuar në mbështetje të ngjizjes së vetëdijes kombëtare.

Fjalë kyçe: *Kurani, kthim (shqipërim), kujtesë letrare, vëllazërim fetar*

⁴ Prof. Asoc. Dr. Rahim OMBASHI

rombashi@beder.edu.al

Dekan i Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

Kolegji Universitar “Bedër”,

Tiranë-Albania

REALISTIC ASSISTANCE IN STRENGTHENING RELIGIOUS CULTURAL IDENTITY

Abstract

The partial translation (Albanianization) of the *Qur'an* by the Christian compatriot Ilo Mitkë Qafëzezi, helped to conceive the national consciousness. The paper plays a role in discovering how much and how this cultural activity could overcome the usual impossible, which hindered the bringing of the *Holy Book* in the Albanian language. The established communication between the religious communities in Albania supported the conviction of the self-taught scholar that the written works would help strengthen the collective memory. At the same time, the article shows the respect for the humanist, who dared to bring in Albanian from English some suras of the *Qur'an*. The contribution given by the founding member of the Xaverjan Albanological Academy to the strengthening of the '*religious brotherhood*', literaryized the collective memory. The scholar acknowledges in the preface to the 1921 edition how much the impossible proof had yielded. It proves the motivating reason, not only religious or philological: , I am translating the *Qur'an* into Albanian, from the English language "(The *Qur'an* The Reading, 1921: 3) Part of the national identity together with the Albanian language is the Albanian culture, therefore the anthropologist tried to bring in the Albanian language only fragments of the holy book for Muslims, because the *Bible* was brought into Albanian about half a century ago. The author's visionary dedication helped to strengthen the Muslim religious identity, as part of the national one. In conclusion, the realism of this scientific and cultural enterprise coincides with the patriotic time, which he felt was a continuation of the 'Prizrën's faith days'. I. M. Qafëzezi proves through this realistic literary act the realization of his own mission in the right place, which came after this marked approach in support of the conception of national consciousness.

Keywords: *Qur'an*, return (Albanianization), literary memory, religious brotherhood

Universiteti i Elbasanit 12 maj 2022
Kujtesa kolektive dhe identiteti kombëtar

Akset kryesore përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm në:

- Roli i medias në formësimin e kujtesës kolektive
- Historia nga dritarja e medias si reflektim i politikave editoriale
- Kujtesa e letrarizuar
- Kujtesa kolektive në epokën digjitale
- Përdorimet dhe keqpërdorimet e kujtesës
- Kujtesa politike dhe politika e kujtesës: Rikontekstualizimi i së shkuarës në shërbim të së sotmes dhe të ardhmes
- Letërsia si medium i kujtesës kulturore
- Kujtesa kolektive dhe identiteti kombëtar
- Kujtesa si formë e harresës – mbi manipulimin e kujtesës
- Kujtesa dhe identiteti kulturor folklorik
- Kujtesa dhe mitologjia – krijimi i miteve si produkt i kujtesës kolektive
- Kujtesa kolektive dhe tradita orale

Për pjesëmarrje, ju lutem sillni këto të dhëna:

Titulli

Abstrakt (250 - 300 fjalë në shqip dhe anglisht)

Fjalë kyç (5)

Autori/e (t)

Përshkrim i shkurtër i autorit/autore

Në debatin që zhvilloi në tribunë, ai (Ibrahim Rugova) tha se të krijosh kulturën tënde nuk është provincializëm, siç preferojnë disa kozmopolitë, që vërtet duan të ruajnë provincializmin e vet. Të merresh me veten njëherësh është individualizëm dhe universalizëm dhe se pa individualitet nuk ka universalitet. Në të gjitha teoritë estetike e filozofike të sotme çmohet vepra e shkrimtarit dhe nuk vendoset njëanshëm për te në bazë të personalitetit

qytetar të shkrimtarit, sepse vepra e mirë gjithmonë e kapërcen personalitetin qytetar të shkrimtarit. (Gani Mehmetaj, *Panorama*, 3 maj 2022)

“Të lexosh një autor të së shkuarës, sipas T. S. Eliot, do të thotë të bësh një tërtherje (neologjizëm i krijuar nga Naum Veqilharxhi në vend të fjalës *sakrificë*), të heqësh dorë momentalisht nga e tashmja jote dhe personaliteti yt në këmbim të diçkaje më të çmuar. Të krijosh intimitet me të vdekurit.”

Duket studenti i Harvardit dhe Nobelisti i letërsisë e pranonte se njeriu, si mbyll detyrimet në këtë botë të përkohshme, mban lidhje me të nëpërmjet veprës që ka lënë, asaj ‘diçkaje më të çmuar’, e cila na ka mbledhur në këtë tubim të fisshëm dhe njwherazi shkencor. Dhe ajo qw zbulojmw tani, kur kemi nw dorw kthimin (shqipërimin) e pjesshëm të *Kuranit* nga Ilo Mitkë Qafëzezi, nuk qenka vetëm vlerë gjuhësore, albanologjike, artistike dhe kulturore. prandaj një shekull më pas, edhe në se nuk e përkujtuan në qytetin e vendin e vet (në Korçë, por edhe nw Tiranw e gjetiu nuk u krye ndonjë veprimtari përkujtimore shkencore në këtë lëmë të dijes), ia vlerësoi veprën Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame i BIK, Prishtina, Kosova, ajo pjesë e kombit që tashmë ka dhe shtetin e vet.

Një shekull dhe më herët për qytetin e Mësonjëtores së Parë Shqipe gazeta turke *Aksham* shkruan:

“Si kush e din që Korça është çerdhja e llatinxhinjve. Atje ndodhet një çetë e fortë që prej një kohe të gjatë po merret më propaganda, mundohen për të ringjallur vetëqeverimin kombëtar. Tashti për me i derdh një squfur në rrënjët e tyre, shkolla shqipe po mbyllet edhe kryetarët e tyre u internuan. Hafiz Aliu (Korça) u internua në Spartën e Konjës, Orhan beu në Marash, Emin Milka në Urfa, Hysejn Qani Ballanca në Tokat, Sulejman Ohrija në Nigde dhe Thoma Mihal Markoja në Manastir.”

(Ombashi, 2020: 219)

Në këtë qytet u rrit dhe zhvilloi veprimtarinë e tij Hafiz Ali Korça, autori i poemës së ndjerë për Kosovën *Vajtimet e Atdheut*, për të cilën studiuesi Mahmud Hysa shkon aq lart, kur e vlerëson se “... mund të krahasohet lirisht me atë të Mitrush Kutelit.”

Kumtesa do të rreket të saktësojë ndonjë të dhënë jo të saktë dhe të argumentojë sesi kthimi (shqipërimi) i pjesshëm i *Kuranit* nga Ilo Mitko Qafëzezi, i cili u rrit në atë mjedis ku fryma perëndimore ndihej fuqishëm, ndihmoi në forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

Fillojmë nga pohimi i islamologut me frymë e gjuhë bashkëkohore Ramadan Shkodra:

“Punën e parë serioze në këtë drejtim e ndërmori Ilo Mitko Qafëzezi, i cili në Ploeshti të Rumanisë, më 1921, kishte botuar të përkthyer në shqip 6 suret e para të *Kuranit*.”

Te libri “*KURA’NI* përkthyer shqip prej I.M.Q., shtypur në Rumani”, pas kushtimit “*Bashkatdhetarëvet Kombëtarë të Shtetevet të Bashkuara t’Amerikës* u dedikohet.” është vendosur grishja që fton bashkatdhetarët për t’u futur “në rradhë qytetërimi.” Madje Qafëzezi guxon dhe të paralajmërojë: “Tjetrazi, jemi të humbur...” Në fund të asaj fjale zemre, pas akronimit I.M.Q., një radhë më poshtë, autori shënon: “RUMANI-Paulești-Prähova, më 10 Mars 1921”, që siguron se ky mjedis i vogël administrativ, Păulești, është një komunë në Qarkun Prahova, Muntenia, Rumani dhe njëkohësisht vendi i shtypjes së librit.

Që të mos flitet për uthullën e të kapërcehet tek qumështi, do të rrekemi të saktësojmë sesa Qafëzezi, që ‘mihte thellë në histori’, sipas akademikut Zef Valentini, mundi të tejkalonte ylberin e kohës plot ngjyra të feksura fetare. E mbështet fort qartësimin se çfarë u mboll dhe mbiu në këtë arë më se

profesionale maksima e akademikut boshnjak Enes Kariç, i cili te libri *Si të komentohet Kur'ani* qartëson:

“*Kur'ani* nuk mund të përkthehet, por *Kur'ani* duhet të përkthehet (komentohet)!”

Të rejat e sjella në këtë veprimtari shkencore do të japin kontribut duke dobësuar keqkuptimet e përhapura përmes stilit funksional fetar, ku një qasje vazhdimisht evolucionare dhe njohëse për studimin e fesë është, në vend të kësaj të përdorur deri tani gjerësisht, mjeti shkencor më premtues dhe themelor për të kapërcyer hendekun midis shkencave humane dhe shkencave natyrore, edhe pse vijon të mbetet një qëllim afatgjatë.

Shpjegimin dhe njëherazi argumentin për ta bërë këtë hap e ofron studiuesi Ambasciano që thekson se “gjuha e vjetëruar e ‘*kulturave aborigjene*’ si muze në ajër të hapur për të kaluarën tonë është e rrënjosur në keqkuptimet e lartpërmendura dhe, megjithëse në thelb me të meta, është ende shumë e gjallë.” Kësisoj hulumtimi, i cili mbështet dhe vlerëson ndihmesën mirënjohëse për të nderuar njeriun e letrave I. M. Qafëzezi, i cili guxoi të sjellë në shqipe nga anglishtja disa sure të *Kuranit*, synon ta vendosë në vendin e duhur, që i shërbeu jo vetëm kohës historike dhe akademike, por edhe epokës etnike.

Ilo Mitkë Qafëzezi, kombëtari misionar, anëtari themelues i Akademisë Albanologjike Xaverjane, themeluar në vitin 1937, ku u botuan për një kohë të shkurtër rreth 400 libra, që e pranon te parathënia e botimit të vet të vitit 1921 sesa rezultat kishte dhënë sprovë e kapërcimit të ylberit albanologjik, jep vetë aty shkakun nxitës as vetëm fetar dhe as vetëm filologjik:

“I shtyjtur prej dëshirës që, tani pak-së-paku, është koha të dihet se cila është ajo ‘*cipë qepe*’ misterioze që i ndan fetarisht Shqipëtarët Muhamedanë nga vëllëzërit e tyre të Krështerë, po jap të përkthyer Shqip *Kuránin*, nga gjuha Inglize – përkthim nga *Arabishtja* prej z. George Sales, transllator i shprovuar i *Këndimit Hyjnor*.” (KURA`NI KËNDIMI, 1921: 3)

Si firmëtar i akademizmit albanologjik duke qenë i qartë se pjesë e identitetit kombëtar bashkë me gjuhën shqipe ishte edhe kultura shqiptare, u rrek të sjellë në gjuhën tonë *Librin e shenjtë*, i cili ndihmonte për forcimin e identitetit fetar mysliman, si pjesë e atij etnik, siç ka sqaruar islamologu durimtar dhe kërkuesi shkencor i letërsisë shqipe dhe me plot gjetje autentike Qazim Qazimi. Në një monografi shteruese për Muhamet Çamin, poetin alhamiado, i cili e ka vijuar veprimtarinë e vet poetike duke shkruar në gjuhën shqipe dhe me alfabet arab, ka sqaruar se shqiptarët e përdorën atë lloj alfabeti duke e përshtatur për shqipen, siç kanë bërë edhe persët, osmanët etj. Duket qartë se fryma e krijuar aso kohe kishte lindur më herët, prandaj nuk do të shuhej, ngase realizmi i asaj ndërmarrjeje shkencore me mison kombëtar përkoi dhe përkon me kohën etnike, që akademiku ndiente se ishte vazhde e sendërtim i ‘ditëvet besëprizrënase’:

“Përderisa myslimanët përkthimit të *Kuranit* i hyjnë si të një libri fetar të zbritur nga Allahu (xh.sh.) me qëllim që të mësojnë nga ai në gjuhën e tyre, jomyslimanët përkthimit të *Kuranit*, të shumtën, i hyjnë për qëllime tendencioze dhe sidomos për qëllime misionariste.” (Shkodra, 2005)

Bashkohem me jo pak shkrime serioze që vlerësojnë gjetjet e nismëtarëve, të cilët iu vunë punës për sjelljen e *Kuranit Fisnik* në gjuhën tonë të lashtë, si nevojë e domosdoshmëri, por më duhet të qëndroj te një detaj, që vlen të ndreqet:

“Përkthimit të *Kuranit* në gjuhën shqipe, pas vendosjes së sistemit komunist në Shqipëri, iu vu edhe dijetari shkodran, imam Vehbi Ismaili, në Nju-Xhersi të ShBA-së (R. O: Detroit, Michigan, USA), por, fatkeqësisht, edhe ky dorëshkrim nuk arriti të botohej dhe i qe grabitur nga një keqbërës rrugës për në shtypshkronjë. (Tërnavë, Naim. 1991: 29)

Mësohet se ka një dorëshkrim që duhet kërkuar në ASHSH dhe një qartësim për informacionin me vlerë të zotëri Tërnavës 20 vjet më parë, që imam Vehbiun e këtillon siç ishte në të vërtetë: dijetar.

Për disa vjet bashkëpunova në AIC Detroit, Michigan, USA me prijësin e shquar dhe jo një herë ma ka përsëritur dhembjen e humbjes së dorëshkrimit të punës së vet më të vlefshme të jetës, por jo në Nju-Xhersi, sepse ai jetoj dhe punoj në Detroit. Më dha disa materiale autentike, që i botova te libri *Po vjen Noli...*, të cilin ia kam kushtuar atij burri e prijësi kombëtar dhe fetar, por që u bë një me termin Imam.

Sipas kronologjisë së sprovave për të sjellë *Kuranin* në shqipe, në krye të saj është një nga frashëllinjtë e mëdhenj, bektashiu Naim dhe pas tij ecën në udhën e çelur kristiani ortodoks Ilo Mitkë Qafzezi, njëri nip me shenjë e tjetri bir i vyer i qytetit të Korçës. Vjuan këtë udhë personalitete, madje së fundi gjejmë një të dhënë që duhet hulumtuar për t’u pranuar si dokument:

“Këto të dhëna që u përmendën si dhe faktin se Ali Asllani ka bërë përkthimin e *Kur’anit* në gjuhën shqipe m’i ka konfirmuar qysh më 1991, Bardhyl Fico, i biri i Rauf Ficos.” (Hysi, 2007)

Shtoj dhe një tjetër autor, pa thënë se përfundova listën jo të shkurtër të atyre që iu futën kësaj sprove jo vetëm gjuhësore apo artistike:

“Po ashtu, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, nën mbikëqyrjen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, shënojmë dhe një nismë për përkthimin

e *Kuranit* në gjuhën shqipe. Më 1944 ishte bërë edhe një përkthim, dorëshkrimi i të cilit, sipas z. Ali Musa Bashës, ka përfunduar në Arkivin e Shtetit Shqiptar. (Basha, Ali Musa, 1996: 23-24)

Për të gjitha ato punime ka pasur jo pak vëmendje nga studiues, hulumtues dhe publicistë të fushës, veçse si në shkrime të mirëfillta shkencore apo në shkrime shkencore-popullore, fjala kyç është ‘përkthej’, tek e cila do të qëndroj për ta shkoqitur kuptimisht. Termi ‘përkthej’ më thotë shumë më tepër se fjala ‘përkthej’, që ka këtë kuptim leksikor:

PËRKTHEJ *kal.*

1. Kthej me shkrim a me gojë diçka nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, duke e ruajtur tërësisht kuptimin e fjalëve e të frazave, e shpreh me fjalët e një gjuhë tjetër atë që është shkruar ose që është thënë, duke i ruajtur plotësisht përmbajtjen. Përkthej një roman (një vjershë). Përkthej nga anglishtja (nga frëngjishtja, nga rusishtja). Përkthej nga shqipja në italisht. Përkthen lirisht. E përktheu fjalë për fjalë. Përkthej me gojë (me shkrim). (*Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, 1980, Tiranë) ose fjalori.shkenca.org

Fan Noli guxoi në vitin 1927 të shkruante vetëm ‘shqipëroj’, për sjelljen në shqipe të *Rubairave* të Khajamit, term që është larg shumë nga ‘përkthej’. Në anë tjetër, Qafëzezi i cili ka ndjerë jo vetëm narrativën e kumtit kuranor, por edhe frymën e tij poetike, shkon më lart:

« Në vijim autori e informon lexuesin se veç përkthimit në gjuhën angleze të George Sales, që e ka pasur si bazë për përkthimin e *Kuranit* në gjuhën shqipe, ka konsultuar edhe përkthimin e *Kuranit* në gjuhën frënge të M. Savary, për të cilin shprehet “Prej këtij adoptova më fort numurëlimin e *versetave*, mbasi z. Sales nuk e ka përdorur, gjë` që i-a humbet, sa-do-mos, Librit të Shenjtë frymën poetike. »

(Ombashi, 2020: 118)

Gjithsesi, përkthimi artistik nuk ka qenë qëllim i Qafëzezit, i cili duke ndarë veprimtarinë atdhetare nga përkthimi si zotësi shkencore dhe hartuese del me këtë konstatim:

“Të jetë një ndihmë, sado e pakët për atë teollog që dotë ketë fatbardhësinë të përkthenjë *Kuranin* nga Arabishtja. (*KURA`NI KËNDIMI*, 1921: 3)

Sipas teorive të përkthimit letrar dhe veçmas atij poetik, profesioni i parë i qenies humane është zemra e *hermeneutikës* (Hermesi mitik shkoqiste kuptimin e teksteve). Fridrih Shlejemaker (Fridrich Schleiermacher, 1769-1834) e themeloi *hermeneutikën* si një teori të përgjithshme të interpretimit, si një art universal të kuptimit, të zbatuar në të gjitha sferat e dijes humanitare, para së gjithash, në filozofi. Sipas fjalëve të tij:

“Hermeneutika është shkenca që i largohet keqkuptimit, e cila duhet të themelohet në bazë të një kodi gramatik dhe psikologjik të interpretimit.”

Si parim të rëndësishëm, ai futi argumentimin e domosdoshmërisë për të kuptuar jo vetëm tekstin, por edhe individualitetin e hartuesit të tij. Për këtë duhej riprodhuar, si të thuash, akti kompozues i autorit të veprës. Kjo e shtyu Shlejemakerin të formulojë tezën e tij aq popullore për shkencëtarët e letërsisë, sipas së cilës ‘përkthyesi apo interpreti duhet ta njohë shkrimtarin më mirë sesa e njeh ai veten e tij’.

Përgjatë rindërtimit të aktit ngjizës, përkthyesi-shkencëtar ka mundësi të mbërrijë apo përkapë diç, që deri në fund nuk ka qenë e qartë për vetë hartuesin e veprës. Sipas tij, individualitetin e autorit duhet ta mbërrish drejtpërsëdrejti, duke e shndërruar veten në tjetrin-autor. Metoda e kuptimit të këtij teoricieni është sa krahasuese (për të është i domosdoshëm krahasimi me të tërën), aq edhe hyjnizuese (hamendësimi, intuita, përndritja gjatë riprodhimit të aktit të veprës së huaj). Kjo nënkupton një cikël të njëpasnjëshëm të interpretimit gjatë ndërkalimit nga e përveçmja

tek e përgjithshmja dhe anasjellas, derisa të jetë përkapur kuptimi, sepse ‘asgjë e interpretuar nuk mund të kuptohet vetëm me një herë’.

Si titullar i lëndës *Teoritë e përkthimit*, për të bërë krahasimin midis tekstit origjinal dhe atij të përkthyer, zgjedh poezinë e J. V. Gëtes *Mbreti i Tulës* përkthyer nga Ndre Mjeda më herët e më pas nga Sejfulla Maleshova, Vehbi Bala, Jorgo Bllaci e të tjerë. Në këtë kurs të plotë teoriko-praktik, që merret në ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave” të programit të studimit *Shkenca komunikimi*, profili *Gazetari*, mjaft studentë kanë argumentuar dhe pranuar se përkthimi i Mjedës është më i bukur se origjinali. Fill për këtë arsye themelore, fjalën ‘përkthej’, siç e keni vënë re më lart, nuk e përdor si term të studimeve të letërsisë artistike, por me kuptimin leksikor të përgjithshëm relativizues.

Kjo peshë e rëndë e shtyu Kryetarin e Parlamentit të parë Shqiptar dhe më pas Kryetarin e parë të KMSH të paralajmërojë:

Deklaratë e Krye Myftiut

“Nji punë aqë e randë asht kjo qi edhe të dijsmit me famë e të njoftun edhe n’Europë si Fahredin Raziu me shokë kanë mbet të dridhueshëm në përmbushjen e sajë.”

Vehbi (d.v.)

Kolana “Zani i Naltë”, 1: 1923-1924-1925, fq. 384.

Nr. 12, shtator 1924.

Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kur’anit në gjuhën shqipe, titullohet shkrimi grishës i Elez Ismailit, botuar te *Zëri Islam* në vitin 2016, që dëshmon se ende ka nevojë për ndihmesa në këtë lëmë të dijes. (Ismaili, 2016)

Studimi i rolit të fesë gjatë Rilindjes sonë Kombëtare, padyshim, bën pjesë në mesin e temave, të cilat në historiografinë dhe albanologjinë shqiptare nuk janë bërë sa d h e s i duhet objekt i studimit, madje dhe më tej, për ngjarje

dhe figura historike ka pasur heshtim institucional. Dihet shumë mirë se besimet fetare, në momentet më kyçe të vendosjes së fatit të kombeve të ndryshëm, kanë luajtur rol të rëndësishëm, e që vazhdojnë ta luajnë edhe sot. Nga ky rregull nuk përjashtohen as shqiptarët, të cilët, në çastet kulmore të historisë së tyre, u ngritën, u organizuan dhe punuan e luftuan me besë, penë e armë kundër pushtuesve të huaj, duke e vënë në veprim me këtë rast edhe elementin fetar.

Studiuesi Memli Krasniqi në një punim që mbulon periudhën kohore nga viti 1814-1897, argumenton se koha solli në arenën botërore një organizim të ri social, ekonomik dhe politik, i cili, në masën më të madhe, u mbështet në vlerat shpirtërore dhe morale të Kishave Protestante që si themel kishin edhe vlerat e lashta greke e romake:

“Dëshira për të studiuar dhe për të shkruar mbi ndikimin dominues fesë (të religjionit) në krijimin ose modelimin e mentaliteteve, jo vetëm të atyre individuale dhe sociale, por edhe të atyre etnike, më ka lindur disa vite para se vërtetë t’ia filloja punës për realizimin e këtij studimi. Nxitësi, padyshim vendimtar, për t’u marrë me këtë temë ishte libri *Sëmundja teknokrate* i autorit Alain Peyrefitte. Gjatë leximit të këtij libri mbeta i habitur me guximin e autorit. Duke e krahasuar të kaluarën e popullit francez dhe të atij gjerman, ky autor gjen argumente dhe nxjerr përfundime të logjikshme, për të dëshmuar arsyet e suksesit gjerman në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore dhe njëkohësisht qartësisht zbulon të metat dhe dobësitë e shoqërisë franceze.” (Krasniqi, 2013)

Asaj që e pranojnë shkencat ekonomike se për zhvillimin ekonomik të një vendi duhet kapital dhe faktori njeri, Peyrefitte i shton edhe kulturën si faktor përcaktues në krijimin e mendësisë dhe shprehive prodhuese.

Studiuesi i guximshëm francez shpjegon arsyet se pse revolucioni industrial dhe fryma e re kapitaliste së pari lulëzuan në vendet evropiane protestante. Një nga arsyet e këtij sukcesi protestant, ngulmon ai, është përkthimi i *Biblës* nga latinishtja zyrtare në gjermanishten e folur nga Martin

Luteri e pastaj në gjuhët popullore të vendeve të Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Promovimi i gjuhëve të folura theu monopolin gjuhësor latin të Kishës Katolike si edhe unitetin shpirtëror të Perëndimit katolik.

Thyerja e këtij dogmatizmi dhe centralizimi zgjeroi hapësirat e lirisë së kishave protestante, forcoi frymën lokale dhe etnike në kishat e këtyre vendeve, theksoi tiparet ndryshe të mendësive vendore dhe u cceli udhë marrjes së më shumë përgjegjësive vetjake dhe kolektive. Në vijim, sipas teorisë, lind dhe zhvillohet një mënyre të re e të menduarit dhe e të vepruarit, që rriti kujdesin për edukimin e banorëve të borgeve (varosheve, periferive) urbane dhe pastaj të zonave rurale, gjithnjë në frymë fetare.

Vargu i Pashko Vasës “Feja e shqyptarit asht shqyptaria” është interpretuar tinëzisht e ideologjikisht, sepse faktet flasin që ndikimi i fesë në epokën e rizgjimit tonë kombëtar ka qenë konkret. *Shoqëria Biblike Britanike* ka dhënë një kontribut të vyer jo vetëm për komunitetin e krishterë, por edhe për bashkëkombasit e besimeve të tjera.

“Nga takimet që pati me Naim Frashërin, Gjerasim Qiriazi erdhi në përfundim se për ta siguruar ekzistencën e popullit shqiptar, duhet të botohen tekste shkollore në gjuhën amtare. Kështu, në vitin 1889, ai përgatiti dhe përshtati si tekste shkollore pesë librat e parë të *Biblës*. Alfabeti me të cilin u botuan këto vepra ishte ai i Stambollit, i cili ishte rezultat i marrëveshjes së Shoqërisë Biblike me Naim Frashërin. (Krasniqi, 2013: 387)

Ndonëse protestantizmi, si doktrinë fetare, nuk pati shtrirje dhe ndikim të gjerë në mjedisin ballkanik, pra as në atë shqiptar, misionet protestante mundën t’i mbështesin dy synimet e paracaktuara: arsimimin dhe edukimin masiv:

“Për ndryshim prej tyre, *Bektashizmi* pati lulëzim të plotë në mjedisin shqiptar, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XIX, sepse arriti të identifikohej plotësisht me idetë kombëtare shqiptare, si dhe me pranimin e menjëhershëm të alfabetit me shenja latine, që ishte një veprim simbolik, i cili tregonte orientimin drejt vlerave evropiane. (Krasniqi, 2013: 390).

Me të drejtë është dalë te përfundimi:

Prandaj, laiciteti - së pari të qenit shqiptar, i shoqëruar me bashkëjetesë fetare, u bë tipari kryesor i nacionalizmit shqiptar. (Demjaha & Peci, 2016: 79)

Manastiri, kryeqendra e vilajetit dhe qyteti multikulturor i familjes Qiriazhi kishte marrëdhënie të shumta me nahijen e Korçës, prandaj ata e zgjodhën atë qytet për çeljen e shkollës së parë të vashave më 1891, ku do të shkolloheshin pa dallim fetar. Edhe Qafëzezi ka drejtuar shkollën e vllahëve në qytet dhe me siguri që ka parë ndikimin e saj në jetën e qytetit dhe krahinës, por ndikimi i protestanizmit mbi atë do të ketë filluar qysh gjatë periudhës së tij të mërgimit në Rumani dhe do të jetë përforcuar prej mërgatës shqiptare në SHBA, ku aso kohe kishin mërguar motrat Qiriazhi, me të cilat ka bashkëpunuar gjatë. I bindur se kultura është pjesë e identitetit kombëtar, ai thekson:

“Historia edhe gjuha janë lidhjet më të shëndosha që i bashkojnë njerëzit e njëj kombi. Përandaja ndër përhapësit e idhesë, kombëtare shqipëtare dhe të bashkimit kombëtar ndë ditët para e pas Besës së Prizrenit gjejmë, përveç Veqilharxhit - prekursorit të parë të të zgjuarit të ndërgjegjes kombëtare - një Girolamo de Radë, Hoxhë Tahsin, Kupitor, Mitro Kamardë, Mitko, Vreto, Thimjo Kreji, Sami Frashëri e të tjerë, që janë hedh urë me shpirt e me zemër në studime historike e ligjistike, të cilat, për pasonjë, patnë çvillimin

shkallësisht të kulturës shqipe në llaust dhe, më pas, pamvarësinë t'ënë kombëtare.

Këjo apostullatë shqipëtare e botonjësit të "Valëvet të Detit" që ka qënë Spiro Dineja Vithkuqari, do të duket ndë dritë shumë më të çkëlqyerë edhe prej serisë së dorëshkrimevet të "Kolekcionit Dine" që kemi premtuar dhe kemi nisur t'i nxierim në disa kopje, në origjinale me grafinë shqipe të sotme, dhe të cilat përfaqësojnë një pjesë të plejadës së intelektualëve më të zgjedhurë të ditëvet besëprizrënase." (Gazeta *Tomori*, Tiranë 21 -22 janar 1943). Përgatitur nga Maksim Gjinaj

Duke ecur me përkushtimin dhe seriozitetin e duhur në këtë dhiare, që do t'u çelte udhë studimeve akademike, Qafëzezi u vlerësua duke u pranuar tek Instituti Mbretnuer i Studimeve Shqiptare, shkurt Instituti i Studimeve Shqiptare (1940-1944), një qendër shkencore e kulturore e çelur përgjatë Mbretërisë Shqiptare dhe që duke ecur në hullinë e çelur disa vite më parë, i parapriu Institutit të Shkencave, që shërbeu si themel për ngjizjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në të parin institucion akademik kombëtar, Qafëzezi u zgjodh midis 48 anëtarëve të përjetshëm që formonin edhe Këshillin e Përgjithshëm. Kryetar i tij u zgjodh Ernest Koliqi, kurse sekretar i përgjithshëm At Zef Valentini. Duke parë që anëtarë të këtij institucioni ishin ikona të inteligjencies shqiptare, si: Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, At Anton Harapi, Karl Gurakuqi, Lasgush Poradeci, Namik Resuli, Dom Lazër Shantoja, Filip Fishta, At Justin Rrota, Anton Paluca, Xhevat Korça, Kolë Kamsi, Ekrem Vlora, Sotir Kolea, Vangjel Koça, Dhimitër Berati etj, pranon që autodidakti me gjetjet e veta kërkimore kishte bërë vend midis prijësve të elitës shqiptare të dijes. (AQSH, F. 200, V. 1940, D. 1.)

Studimet albanologjike aso kohe e ngritën qendrën në Tiranë, pas kohësh që kryeshin nga të huajt dhe jashtë atdheut, prandaj atë e vlerësonin personalisht, siç nuk ndodh zakonisht, edhe në Korçën e arsimit dhe të sqimës kombëtare, në qytetin e vet, siç dëshmon bejtja miqësore e satiristit Kapa (Kristaq Cepa) te rubrika humoristike *Kartolinë urimi për vitin e ri 1940*:

“Xhaxhi Ilos Qafëzes / I kam sjellë plot një thes / Dokumenta 40 okë / Dhaskal Todhër, Dhaskal Gjokë.”

Me mençuri, përkushtim intelektual e kombëtar, që të mos ftohej fryma që ngroh shpirti i lirisë, më tepër se me shkollim në auditore universitare në gjuhë e vende të huaja, ai u vendos në listën e shkurtër të personaliteteve të kombit, që mbi Kushtetuta e Gjykata ka vënë Besën e dëlirë. Shqiptari mysliman vihet në ‘be’, theksohet te *Kanuni i Maleve*, mbasi ka marrë avdes...

Kur betohej për të mbrojtur lirinë e vet, nuk harronte të mos e kalonte të drejtën e tjetrit, duke e futur brenda në zemër. Dhe ngjiste aq shumë me normat etike të popujve më të qytetëruar. Në fjalimin mbi “Shpirtin e lirisë” mbajtur në Central Park të qytetit të New Yorkut, gjyqtari i shquar amerikan Learned Hand theksoi:

“Liria qëndron në zemrat e burrave dhe grave. Kur ajo vdes atje, asnjë Kushtetutë, asnjë ligj, asnjë Gjykatë nuk mund ta shpëtojë atë; asnjë Kushtetutë, asnjë ligj, asnjë Gjykatë nuk mund ta ndihmojë atë. Nëse liria qëndron në zemrat e njerëzve, nuk ka nevojë për Kushtetutë, ligj, Gjykatë për ta shpëtuar.”

Për besimtarin mysliman liria nuk është vullnet i pamëshirshëm, i shfrenuar; nuk është liri të bësh si të duash, sepse ky është mohimi i lirisë dhe çon drejt

përmbysjes së saj. Një shoqëri, në të cilën disa njerëz nuk njohin asnjë kontroll mbi lirinë e tyre, së shpejti bëhet një shoqëri ku liria është pronë vetëm e më të fortit, siç edhe e provoi fatkeqësisht.

Pas Luftës së Dytë Botërore, qysh nga viti 1945, ai vijoi të nderohej rastësisht nga institucionet rishtare, duke u ftuar në tubime kulturore “teku isha edhe si mysafir zyrtar i kongresit të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë”, siç pohon vetë te një letër që ia drejton një shtetari të lartë të kohës. Nuk vijoi gjatë, sepse pas ndezjes së motorit të luftës së klasave si forcë lëvizëse e shoqërisë moniste, mbështetur me entuziazëm nga zyrtarët e rinj të emëruar politikisht, nënçmimit të etikës dhe fabrikimit të moralit intelektual, Qafëzezit iu desh të përballej me tjetërsimin e veprës hulumtuese dhe studiuese, madje arrihej deri te moscekja e pronësinë intelektuale apo deri në përvetësimin e saj.

Studiuesi kishte depozituar gjatë Luftës në Institutin e Studimeve Shqiptare disa vepra të veta, që kaluan pas nëntorit 1944 në pronësi të Institutit të Shkencave, ku drejtonte Manol Konomi, i cili njëherazi ishte dhe Ministër i Drejtësisë.

Te studimi *Tjetërsimi i veprës intelektuale gjatë komunizmit në Shqipëri* (1944-1990), i autorit Leka Ndoja, mësohet se Shuteriqi i ri, i cili nuk i njihte dy gjuhët e vdekura të kulturës botërore: greqisht dhe latinisht, është mbështetur nga mallsjabiu Qafëzezi, ndihmesë e pakursyer që nuk iu shpërblye as me mirënjohje, të paktën, për studimet me karakter epigrafik të shkrimtarëve të vjetër shqiptarë, sidomos të shkollës së Voskopojës, duke mos i paraqitur me akribinë shkencore dhe pa iu cituar pronësinë intelektuale. (Ndoja, 2013: 96)

Sistemi i ri politiko-ekonomik, qysh në ditët e para të tij, do të fillonte shtetëzimin e pronave të pasunarëve të mëdhenj, për të vijuar me ato të pronarëve të mesëm dhe më pas edhe të vegjël. Synimi strategjik i sistemit totalitar ishte shkatërrimi përfundimtar i pronës personale, përfshi edhe asaj intelektuale, çka dëmtoi rëndë dinjitetin qytetar e deri ndërgjegjen e brishtë kombëtare.

Në tetor të vitit 1945, Qafëzezi i moshuar dhe i sëmurë ngre shqetësimin e tij për mbijetesë sepse po “..., vuan urie pas 50 vjet pune të paprajtun në fushë të Shqypes.” Duket nga mendësia universale apo puna e shumtë ngulmuese në kërkim të thesarit kulturor kombëtar, nuk ka mundur të kontaktojë me shkrime që përhapnin e propagandonin teorinë marksiste-leniniste, prandaj mendon se ende zotëron dinjitetin e dikurshëm, që bashkë me vlerat e tjera kërkon të mbështetet edhe nga e drejta e lëvizjes, e cila do të humbte fare pas prishjes politike me Jugosllavinë federative.

Në letrën dërguar Nako Spirut, drejtues i lartë i aparatit shtetëror njëpartiak dhe njëkohësisht kryetar i Organizatës së Rinisë Antifashiste të Shqipërisë, shkruhet:

Dokumenti 20

(1935-1955): Allbanollogji, Histori, Folklor ett.

Rruga Papa Llambro Ballamaçi 4

Nr. Protokolli 291/ 1

VDEKJE FASHIZMIT - LIRI POPULLIT

Korçë, 22 Shëmitër 1945

Shokut NAKO SPIRU

Kryesonjës i "BRASH" -it.

Tiranë

“Shkurtimi,

Mbi çështjen e 13 Dorëshkrimevet të mij, Studime Epirotike Akademike Anti-Kotokiste 5, që i more prej Redakcisë së "Bashkimit" dhe ua këmbeve destinatën, pa përfillur mallsa jibiun (te zon' e djersës) që i punoj plot dy muaj. Ke këputur kësi mënyre, edhe kafshatën buke të fëmijës së një plaku shkrimtar i cili, për arsye pleqërie dhe sëmundje, vuan urie pas 50 vjet pune të paprajtun në fushë të Shqypes.”

Duke iu drejtuar me dinjitet ‘Shokut Nako’, sepse ka besim te ‘Drejtësia e Drejtë’, kërkon një kthjellim të meselesë së vet letrare dhe tregon se i ka lënë kartvizitën, sepse ai nuk e kishte pranuar në pritje:

“I sëmure, më duhej të kthehem në shtëpi, në Korçë, dhe të kërkonj Drejtësi të Drejtë së këtejmi. Po e kërkonj Drejtësinë në Shqipëri, më parë, dhe pastaj, po qe se s'e gjenj dot këtu, po e kërkonj në Beograd, në Bukuresht dhe në Athinë.”

Pas kthjellimit, i jep subjeksionin e pyetjes që ngjan së tepërmi me një akuzë të “papërmetuar prej moralit...”, sepse tertherjen e tij ia kishin dhënë "shokëve" studiues në Beograd:

⁵ Pandeli Kotoko: Metropolit i Gjirokastrës që prej vitit 1937-1941, me origjinë nga Korça, i larguar si fanariot dhe i rrëzuar nga Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Shqiptare.

“- i hodhe ndë pus, apo i përcolle nuk di se ku, në dorë të ndonjë profesori Ballkanas djalosh, nga ata që gjuajnë të afishohen me suksese letrare të lehta, domethënë të përdomjen djersën edhe mundin e tjetrit, lark Vendit të tyre ... “

Mendon 60-vjeçari Qafëzezi se do ta gjejë të drejtën edhe sepse ka miqësi me ‘Shokët e mij’ Dhimitri & Koçi Xoxe (ky i fundit asokohe ishte figurë e parë qendrore e shtetit njëpartiak), por edhe se ka dokumentin mbi materialet e dorëzuara për botim te gazeta “Bashkimi”, ku redaktor ishte Shefqet Musaraj:

“Nga një dokument i Redaksisë së "Bashkimit" më rezullton se Dorëshkrimet e mij janë marë në mest të ditëve 6-10 Shtator 1945, kur - thotë dokumenti - ishin vënë në udhë botimi, me një çpërblim-ndihmë letrare të ofruar bujarisht prej Shtabit të Fletores "për të ndihmuar Xha Ilon" 60-vjeçarin - më nuk më jet tjetër udhë vëçse të rënkonem zyrtarisht në dy Zyra: Pleqësisë së lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë edhe Shokëve të mij Dhimitri & Koçi Xoxe (Babë e Bir).” (Ndoja, Leka. 2013: 100)

Në atë kohë mundet ka të drejtë të ndihet i sigurtë në vetvete, sepse jo vetëm që zyrtarisht ka siguruar reputacion kombëtar dhe ka njohje edhe me institucionet akademike të vendeve fqinje, por duhet të ketë pasur miqësi personale edhe me vetë Spirun (edhe ky ka qenë vllah, ashtu si edhe Xoxe, kur dihet që Qafëzezi ishte vllah nga nëna):

“Po nuk gjeta dot këtu Drejtësi, po e çonj çështjen në Akademitë Beograd, Bukuresht ett. ku jam i njohtur më mirë nga çdo tjetër shkrimtar Arbinesh-Armën.

Punimet e shkrimtarit nuk munden të botohen veçse atje tek i destinon i-zoti i tyre.

I padrejtësuemi prej Teje, Shoku Yt (Ilo Mitkë Qafëzezi). (Qafëzezi, Ilo Mitkë: AQSH, F. 426, D. 4, fl. 16.)

Kështu do të vijonte jo rastësisht t'i zhbëhej ndihmesa (jo vepra) dhe për të si hulumtues i suksesshëm dhe jo më si prijës intelektual nuk do të kujtohej më

kush, deri sa i veshur me harrim u shua në qytetin e vet. Qafzezi nuk e kuptoi kohën ideologjike, ndoshta formimi që kishte apo mosha, por sistemi totalitar nuk mund ta mbante pranë akademikun, personalitetin që punoi pa kursim për forcimin e ndërgjegjes kombëtare, kur propagandohehej internacionalizmi proletar dhe po përgatitej të vendosej antiteizmi zyrtar (jo ateizmi).

Edhe këtë hap shkatërrues e nxitën dhe e realizuan burrat dhe jo prijësat, prandaj zgjedh të citoj Cristopher Morley, sipas të cilit:

“Life is a foreign language: all men mispronounce it.” (Jeta është një gjuhë e huaj: të gjithë burrat e shqiptojnë gabim.)

BIBLIOGRAFI

Arkivi i Institutit të Historisë së Republikës së Shqipërisë, Tiranë. Fondi: *Ilo Mitko Qafëzezi*, D. 14, fl. 26, fashikuj copë 50.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës-Fakulteti i Studimeve Islame. (2006) *Terminologjia Islame*, Prishtinë.

Basha, Ali Musa. (1996) *Përkthimet e hershme të Kur'anit dhe kritikrat për to*; Drita Islame, nr. 23-24, Tiranë.

Berishaj, Anton. (2014) *Religion and Politics in Kosovo*, in Gorana Ognjenović and Jasna Jozelić eds. *Politicization of Religion, the Power of State, Nation, and Faith: The Case of Former Yugoslavia and its Successor States*, New York: Palgrave Macmillan.

Clayer, Nathalie. (2012) *Në fillimet e nacionalizmit Shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë, Botime Përpjekja.

Della, Rocca, Roberto Morozzo. (1994) *Kombësia dhe Feja në Shqipëri (1920-1944)*, Tiranë.

Dizdari, Tair. (2004) *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë.

Fischer, Bernd J. (2005) *A Brief Historical Overview of the Development of Albanian Nationalism*, Presented at East European Studies center discussion on March 23, Washington D.C.

Gewehr, Wesley M. (1931) *The Rise of Nationalism in the Balkans, 1800-1930*. New York: H. Holt and Company.

Hysa, Mahmud. (2000) *Alamiada shqiptare II*, Logos-A, Shkup.

Hysi, Shyqyri. (2007) *Rauf Fico-shtetar dhe diplomat i shquar* (monografi), Tiranë.

Ismaili, Elez. (2016) *Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe*, Zëri Islam.

Jusufi, Azmir. (2019) *Ilo Mitko Qafëzezi dhe përkthimi i parë i pjesshëm i Kur'anit në shqip*, “Zani i Naltë”, shtator, f. 31.

Kaleshi, Hasan. (1976) *Roli i shqiptarëve në Letërsinë Orientale*, Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj, Prishtinë.

Karić, Enes. (2005) *Kako tumačiti Kur'an*, Tugra, f. 50.

Krasniqi, Memli. (2013) *Shoqëria biblike britanike për të huajt dhe bektashizmi (1814-1897)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

KURA`NI (KËNDIMI) (1921) PËRKTHYER SHQIP PREJ I.M.Q., SHTYPUR NDË RUMANI.

Lloshi, Xhevat. (2005) *Kristoforidhi përmes dokumentimit*, Tiranë.

Mehdiu, Feti. (1996) *Përkthimet e Kur'anit në gjuhën shqipe*, Logos-A, Shkup.

Morina, Qemajl. (2003) *Identiteti fetar i shqiptarëve në: Shtresimet e identitetit kulturor shqiptar*, Shoqata Kulturore “Zëri Ynë”, Zëri Ynë, Prishtinë, f. 25-31.

Ndoja, Leka. (2013) *Tjetërsimi i veprës intelektuale gjatë komunizmit në Shqipëri (1944-1990) Studim*, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë.

Ombashi, Rahim. (2002) *Po vjen Noli...*, Kotti, Korçë.

Ombashi, Rahim. (2020) *Historik i shtypit periodik shqiptar (Sprovë për një poetikë historike)*, Tiranë.

Qafëzezi, Ilo Mitkë. (1936) *Dhaskal Gjoka apo Shkolla Korçare e qemoçme*, Korçë.

Qafëzezi, Ilo Mitkë: AQSH, F. 426, D. 4, fl. 16.

Rexhepi, Baba. (2006) *Mistiçizma Islame dhe Bektashizmi*, Tiranë.

Shehu, Hajri. (2006) *Një përkthim i Kuranit i vitit 1921 në gjuhën shqipe*, PERLA, Viti XI, Nr. 2 (41), Botuesi: Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë: 85-92.

Shkodra, Ramadan. (2005) Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor “*Kurani tek shqiptarët*”, organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës më 26-27 dhjetor, Prishtinë.

Tërnavë, Naim. (1991) *Imam Vehbi Ismaili publicist dhe veprimtar i shquar*; Dituria Islame nr. 29, Prishtinë.

Ambrosiano, Leonardo. (2016) *Mind the (Unbridgeable) Gaps: A Cautionary Tale about Pseudoscientific Distortions and Scientific Misconceptions in the Study of Religion*. Method & Theory in the Study of Religion; Vol. 28, No. 2, pp. 141-225 (85 pages); Published By: Brill <https://www.jstor.org/stable/43907228>

Peyrefitte, Alain. (1976) *Le Mal Français* (E keqja franceze-French Evil), Paris: Plan, f. 524.

Le Mal Français (French Evil) By Alain Peyrefitte Paris: Plan, 1976, 524 p. A book that provoked spirited opposition in France when it appeared some months ago. The author, who has distinguished himself as a politician and diplomat, argues that France has become weak and pale, has lost her drive and initiative, has ceased to function effectively- and through no fault but her own. He attributes her decline to the centralization and bureaucratization of state and society, an argument which is not rarely been advanced so passionately and incisively.

Kimmich, C. (1977). *Foreign Affairs*, (4), 912-912. doi: 10.2307/20039775

Demjaha, Agon & Peci, Lulzim. (2016) *What happened to Kosovo Albanians: The impact of religion on the ethnic identity in the state building-period*; KIPRED, POLICY PAPER No. 1/16 – June, Prishtina, Kosovo. <http://www.kipred.org/>

Arti OMERI⁶
Nereida OMERI
Besmira OZUNI

FËMIJËT ME AFTËSI NDRYSHE ME DIAGNOZËN E AUTIZMIT NË SHKOLLË

ABSTRAKT

Gjithëpërfshirja në arsim tani është pjesë edhe e reformës arsimore në Shqipëri dhe jo vetëm. Tema prek të gjithë aktorët: nxënës, prindër, mësues, drejtues, çdo punonjës arsimor, komunitetin, instancat përkatëse të arsimit sipas hierarkisë (nga IA e deri në MAS) pushtetin vendor, organizatat e ndryshme (OJF), të cilat kanë të gjitha si qëllim të përbashkët: *respektimin e të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve*.

Për rëndësinë që mbart dhe ndjeshmërinë që përcjell te gjithsecili nga ne, qoftë si mësues, si prind, apo në çdo këndvështrim tjetër, mendojmë se është i dobishëm dhe interesant trajtimi i saj.

Vitet e fundit, vihet re një rritje e numrit të nxënësve me aftësi ndryshe (AN) ose të veçanta dhe sfida më e madhe në institucionet arsimore është integrimi dhe gjithëpërfshirja e tyre. Ndaj pjesë e objektivave dhe e planifikimit të drejtuesve në shkolla është dhe gjithëpërfshirja.

Këtë mision profesional human shkolla jonë nuk mund ta kryejë e vetme. Ndaj është i domosdoshëm partneriteti shkollë-familje-komunitet, i cili ndjen nevojën e mbështetjes institucionale, veçma asaj shtetërore.

Punimi mbështet gjetjen e studiuesit se shkolla dhe prindërit njëzëri me njëri-tjetrin duhet të njohin mirë personalitetin e fëmijës në tërësi, në procesin e llojeve konkrete të veprimtarisë së tij, në marrëdhëniet e ndërsjella me shokët, me të rriturit, me familjarët në shtëpi, etj.

Fjalë kyçe: *aftësi ndryshe, autizëm, arsim gjithëpërfshirës, integrim, partneriteti shkollë-familje-komunitet, mision.*

⁶Dr. Arti Omeri
aomeri@beder.edu.al
Dr. Nereida Omeri
nereidaomeri@gmail.com
MSc. Besmira Ozuni

ABSTRACT

Inclusion in education is now part of the educational reform in Albania and not only. The topic affects all actors: students, parents, teachers, leaders, every educational worker, the community, the relevant instances of education according to the hierarchy (from IA to MAS), local government, various organizations (NGOs), which all have as common goal: respecting human rights and protecting children's rights.

For the importance it carries and the sensitivity it conveys to each of us, whether as a teacher, as a parent, or in any other perspective, we think that its treatment is useful and interesting.

In recent years, an increase in the number of differently abled (AN) or special students has been observed and the biggest challenge in educational institutions is their integration and inclusion. Therefore, inclusiveness is part of the objectives and planning of school leaders.

Our school cannot carry out this humane professional mission alone. Therefore, the school-family-community partnership is necessary, which feels the need for institutional support, apart from the state one.

The paper supports the finding of the researcher that the school and parents must agree with each other to get to know the child's personality as a whole, in the process of concrete types of his activity, in mutual relations with friends, with adults, with family members at home, etc.

Keywords: *differently abled, autism, inclusive education, integration, school-family-community partnership, mission.*

Hyrje

Meqenëse gjithëpërfshirja në arsim është pjesë e reformës arsimore shqiptare dhe jo vetëm, mendojmë se kjo temë prek të gjithë aktorët: nxënës, prindër, mësues, drejtues, çdo punonjës arimorë, komunitetin, instancat përkatëse të arsimit sipas hierarkisë (nga IA e deri në MAS) pushtetin vendor, organizatat e ndryshme (OJF), të cilat kanë të gjitha një qëllim të përbashkët: *Respektimin e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve*.

Ndaj për rëndësinë që mbart dhe ndjeshmërinë që përcjell te gjithsecili nga ne qoftë si mësues, qoftë si prind, apo në çdo këndvështrim tjetër, mendojmë se është i dobishëm dhe interesant trajtimi i kësaj teme.

Vitet e fundit, vihet re një rritje e numrit të nxënësve me aftësi të veçanta dhe sfida më e madhe në institucionet arsimore është integrimi dhe gjithëpërfshirja e tyre. Ndaj pjesë e objektivave dhe e planifikimit të drejtuesve në shkolla është dhe gjithëpërfshirja.

Por këtë mision shkolla nuk mund ta kryejë e vetme. Ndaj është i domosdoshëm partneriteti shkollë-familje-komunitet.

Meqenëse shumica e nxënësve kanë diagnozën e autizmit le të japim më poshtë përkufizimin për të dhe për konceptet kryesore që lidhen me të:

Autizëm: është një çrregullim i zhvillimit që karakterizohet nga vështirësi të mëdha në komunikim dhe në formimin e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë si dhe në përdorimin e gjuhës dhe koncepteve abstrakte.⁷

Arsim integruar: u referohet masave që merren për të siguruar arsim në sistemin

e shkollave të zakonshme me pak mbështetje ekstra (p.sh. klasa burimore, mësues mbështetës etj.) për fëmijët me nevoja të veçanta. Arsim special: çdo fëmijë është i veçantë dhe çdo fëmijë ka nevojë për mbështetje

⁷ Arsimi gjithëpërfshirës në Shqipëri, studim analitik, Save the children, Tiranë 2013, f. 12.

në procesin e zhvillimit dhe të përshtatjes në jetë. Disa fëmijë kanë më shumë nevojë se të tjerët gjatë viteve të shkollës. Kjo ndihmë e veçantë, speciale, njihet ndryshe si arsim special.

Arsim gjithëpërfshirës: mjedis mësimor që mundëson akses, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit. Arsim gjithëpërfshirës do të thotë që shkollat

duhen përshtatur për të gjithë fëmijët, pavarësisht kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose kushte të tjera. Ndalemi pak më gjerësisht te ky koncept:

Gjithëpërfshirja si koncept dikur nënkuptohej si një qasje e nevojshme vetëm për fëmijët me aftësi të veçanta. Por me shtimin e njohurive në këtë fushë si dhe me përhapjen dhe evoluimin në arsimin shqiptar, sot me gjithëpërfshirje përkufizohet i gjithë procesi që sigurojnë mësuesit për përfshirjen e gjithë nxënësve të klasës apo të shkollës, në veprimtarinë edukative dhe mësimore.⁸(Udhëzuesi i gjithëpërfshirjes-Për Shkollën Qendër Komunitare 2014.) Studiues të tjerë e përkufizojnë gjithëpërfshirjen: “Ristrukturimi i mjediseve shkollore në mënyrë të tillë që të gjithë nxënësit, përfshirë edhe ata me paaftësi të rënda, të mësojnë në të njëjtat mjedise”⁹ (Woolfolk Anita, 2011) Kjo nënkupton se nxënësit me aftësi të veçanta përfshihen në klasë apo në shkollë si të gjithë nxënësit e tjerë. Por për shumicën e kësaj kategorie nxënësish, mësuesit punojnë me program të veçantë për mësimin dhe edukimin e tyre.¹⁰ (Bregu Maliq, 2020, f.13) Studiuesit ndahen në dy grupe sa i përket gjithëpërfshirjes: Mbrojtësit e konceptit të gjithëpërfshirjes mendojnë se nxënësit me paaftësi mund të përfitojnë nga bashkëveprimi me bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë paaftësi dhe se ata duhet të arsimohen së bashku, në shkolla për të gjithë, edhe pse kjo kërkon ndryshime në standardet arsimore, mjete të veçanta ndihmëse, shërbime, trajnime apo konsultime për stafin pedagogjik. Të tjerë studiues tërheqin vëmendjen se

⁸ Udhëzuesi i gjithëpërfshirjes-Për Shkollën Qendër Komunitare. Shkollë miqësore për të gjithë. Mbështetur nga UNICEF. Dhjetor, 2014, f. 6.

⁹ Woolfolk Anita, “Psikologji edukimi”, botimi i njëmbëdhjetë, Qendra për arsim demokratik, Tiranë 2011, f.125.

¹⁰ Bregu Maliq, “Mësimi dhe edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara”, Botimet M&B, Tiranë 2020, f.13.

klasat gjithëpërfshirëse nuk janë vendi më i mirë për çdo fëmijë.¹¹ (Woolfolk Anita, 2011)

Zhvillim

Këta fëmijë duhen trajtuar me dinjitet dhe jo të diskriminohen për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, nga bashkëmoshatarët, apo nga stafi pedagogjik. Këtë e shohim të pasqyruar dhe në Ligjin e Arsimit Parauniversitar, ku shprehimisht thuhet: “Në Republikën e Shqipërisë garantohej e drejta për arsimin e shtetasve shqiptarë, të huajve dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.”¹²(Ligji i arsimit parauniversitar Nr.69/2012.) Prandaj bashkëpunimi shkollë-familje-komunitet për integrimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve me AN është kthyer sot në domosdoshmëri dhe duhet të konsolidohet çdo ditë dhe më shumë. Arsimi gjithëpërfshirës, mund të konsiderohet si një hap i parë drejt përfshirjes sociale dhe është në dobi të të gjithë shoqërisë.¹³ (Arsimi gjithëpërfshirës-e drejtë e secilit. 2014.) Termi gjithëpërfshirje na sjellë ndërmend moton evropiane “Të ndryshëm, por të barabartë”. Nxënësit me AN duhen pranuar ashtu siç janë, si anëtarë të një shoqërie të emancipuar që e pranon diversitetin. Në rregulloren e arsimit parauniversitar ndër të tjera thuhet: “Nxënësi ka të drejtë: të trajtohet me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme në IA, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim, pa dhunë.”¹⁴ (Urdhër nr.31, datë 28.01.2020.).

Dhe në *Ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës* të vitit 2017, në nenin 18 E drejta për arsimim ndër të tjera thuhet: “Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta

¹¹ Woolfolk Anita, “Psikologji edukimi”, botimi i njëmbëdhjetë, Qendra për arsim demokratik, Tiranë 2011, f.125.

¹² Ligji i arsimit parauniversitar Nr.69/2012, Neni 5 *E drejta për arsimim*, f.3.

¹³ Arsimi gjithëpërfshirës-e drejtë e secilit. Broshurë, Shkurt 2014, f.4.

¹⁴ Urdhër nr.31 *Për miratimin e rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*, datë 28.01.2020, Neni 70 *Të drejtat e nxënësve*, f.32.

dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.”¹⁵ (Ligji 18/2017 *Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*.) Pra, kuadri ligjor e thekson se të gjithë fëmijët janë të barabartë para ligjit. Ndaj të gjithë bashkë duhet të bëjmë më të mirën për këta fëmijë. Ata nuk duan mëshirë e as të mbivlerësohen, por duhet të jenë pjesë përbërëse e mozaikut shumëngjyrësh të arsimit gjithëpërfshirës.

Shkolla nuk është e vetme në misionin e saj për integrimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve me AN. Aleatët e saj më efektiv janë prindërit e këtyre fëmijëve, të cilët janë partnerë të saj në edukim. Ata kanë sfidën më të madhe. Të jesh prind i një fëmije me AN nuk është e lehtë. Çdo prind thur ëndrra dhe dëshiron e uron më të mirën për fëmijën e tij, madje ndoshta edhe akoma pa lindur. Mendoni se si do të ndihet ai, kur kupton se fëmijën e tij e ka me vështirësi e me aftësi të kufizuara. Këtu fillon dhe hapi i parë i bashkëpunimit mësues-prind, kur mësuesi bëhet empatik ndaj shqetësimit të prindërve. Vështirësia e mësuesit këtu qëndron se jo vetëm nevojat e nxënësve me AN janë të ndryshme, por dhe prindërimet janë të ndryshme. Secili prind ka të drejtë të mendojë ndryshe për rritjen, edukimin dhe zhvillimin e fëmijës së tij. Kur këta prindër paragjykojnë e kategorizojnë pa marrë parasysh veçoritë dhe specifikat për secilin rast, fillojnë shqetësimet. Ndaj të qenit empatik e bën mësuesin të jetë partnerë së bashku me prindin në edukimin e fëmijës. Gjithashtu mësuesi duhet të dijë se jo çdo fëmijë me AN, hyn në shkollë i identifikuar si i tillë. Dhe pse bëhen përpjekje për t’i identifikuar që në vitet e para të jetës, apo kur janë në kopsht, sërish ndodh që mësuesit e arsimit fillor, veçanërisht mësuesit e klasave të para, të dyta dhe të treta, të evidentojnë në ndonjë nxënës, vështirësitë dhe aftësitë e tyre të kufizuara. Por mund të ndodh edhe kur paaftësitë krijohen për shkak të traumave apo aksidenteve që mund t’u ndodhin disa nxënësve gjatë viteve të shkollës (Manual, Tiranë 2014)¹⁶

Po t’i referohemi studimeve, kjo merr një rëndësi edhe më të veçantë nga fakti se gjatë periudhës së shkollimit rreth 20% e nxënësve rezultojnë të paraqesin nevoja të veçanta (UNESCO, 2000). Sipas të njëjtit burim, vlerësohet se 1 në

¹⁵ Ligji 18/2017 *Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*, Neni 18 *E drejta për arsimim*, f.7.

¹⁶ Manual “Jam mes jush, i ngjashëm, i ndryshëm, i barabartë” World Vision, Tiranë 2014, f.114.

10 fëmijë lind apo pëson gjatë jetës një dëmtim serioz për të cilin, nëse nuk bëhet kujdes, janë të gjitha gjasat që zhvillimi i tij të pengohet.¹⁷

Mësuesi duhet të ketë parasysh disa rregulla në procesin e trajtimit pedagogjik të fëmijëve me AN, si për shembull:

- Të mos kërkohet e pamundura që në fillim të këta fëmijë.
- Të mos kërcënohen, fyhen, frikësohen e të mos ndihen të turpëruar.
- Të rritet besimi i tyre në vetvete.
- Të nxitet tek ta interesi për të mësuar në mënyrë sistematike.
- Të zhvillohet me ta punë e vazhdueshme e diferencuar, individuale në përputhje me veçoritë e moshës së tyre.
- T'u jepen detyra plotësuese në formë garash të lehtësuara.
- Të lihen të lirë për të bërë edhe gjëra të paorganizuara.
- Të dalin në natyrë sa më shumë të jetë e mundur, por me synime të caktuara.
- Të mos i lërë të qëndrojnë pasivë dhe pa u aktivizuar në orën e mësimit.
- Të shikojë dhe të vlerësojë sa më shumë punët e tyre.
- Të mos vërë gjithmonë në dukje vetëm anët negative të tyre etj.¹⁸

Po t'i referohemi konceptit “ *aftësi ndryshe* ” kuptojmë: “*individë me nevoja të*

veçanta i referohet çdo frenimi në kapacitetin e një individi për të marrë pjesë dhe për të përftuar nga edukimi si rezultat i një paaftësie mendore, fizike, shqisore ose një paaftësie në të nxënë, ose nga çdo rrethanë tjetër që e bën individin të mësojë ndryshe nga një person i cili nuk ndodhet në këto rrethana” (U.S. Department of Education, 2008).¹⁹

¹⁷ “Gjithëpërfshirja në arsim-një përmbledhje punimesh kërkimore, mbështetur dhe zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, punimi me temë “Qëndrimet e mësuesve ndaj gjithëpërfshirjes në arsim: Zbulimi i nevojave të tyre gjatë punës me nxënësit me nevoja të veçanta” Msc. Greta Hysi, f. 83.

¹⁸ Bregu Maliq, “Mësimi dhe edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara”, Botimet M&B, Tiranë 2020, f.60.

¹⁹ “Gjithëpërfshirja në arsim-një përmbledhje punimesh kërkimore, mbështetur dhe zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, punimi me temë “Qëndrimet e mësuesve ndaj

Rol kyç për zhvillimin potencial të një nxënësi me AN luan mësuesi ndihmës. Disa nga detyrat e tij janë:

1. Detyra kryesore e tij është mësimi i nxënësit me aftësi të kufizuara si në nivel individual ashtu edhe në grupe të vogla, në bashkëpunim me mësues të tjerë të shkollës. Këtë detyrë ai e zbaton jo vetëm duke u përfshirë në mësimdhënie, në bashkëpunim me mësuesin e klasës apo lëndës dhe duke qëndruar me nxënësit me aftësi të kufizuara në orë të veçanta ku ata kanë më shumë nevojë për ndihmë, por edhe duke dhënë ndihmë specifike edhe në fusha të tjera të nevojshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, siç janë aftësitë sociale dhe aftësitë për jetën.
2. Të ndihmojë tek nxënësit me aftësi të kufizuara për zhvillimin e plotë të potencialit të tyre intelektual dhe fizik.
3. Të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e tjerë në institucionet arsimore të zakonshme (mësuesin kujdestar, mësuesin lëndor, psikologun, apo punonjësin social) për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi ndryshe.
4. Të hartojë planin PEI në bashkëpunim me mësuesin apo mësuesit përkatës, psikologun, apo punonjësin social, prindin dhe ta zbatojë atë pasi të miratohet nga Komisioni i IA për fëmijët me aftësi ndryshe.
5. Të punojë me nxënësit me aftësi ndryshe, krahas mësuesit përkatës në të gjitha orët mësimore vjetore apo në një pjesë të tyre, gjithashtu jashtë klasës, me nxënës të veçantë me aftësi ndryshe ose me grupe të vogla, e preferueshme në grupimet e klasave I-III, IV-V dhe VI-IX.
6. Të bëjë të mundur pjesëmarrjen e tij sa më të plotë në aktivitetet shkollë.

Gjithashtu për të pasur sa më shumë produktivitet në punën me nxënësit me AN duhet që të bashkëveprojnë të gjithë aktorët përgjegjës: mësues lëndor, mësues ndihmës, punonjës psiko-social, përfaqësues të shkollës, mjek terapist etj. Pra, e thënë ndryshe duhet bashkëpunim dhe partneritet i grupit mbështetës (SSG). Por një rol specifik në punën me këta nxënës luan edhe mësuesi ndihmës duke e mbështetur fëmijën në klasë për të përmirësuar

leximin, shkrimin, aftësitë elementare matematikore (aq sa fëmija mund të arrijë), artin dhe sportin. Por puna e mësuesit ndihmës nuk kufizohet vetëm me arritjet akademike të nxënësit. Mësuesi e ndihmon nxënësin që të aftësohet dhe për kujdesin personal, e mbikqyr nëse fëmija ka shqetësime të sigurisë duke e shoqëruar në sesione terapie, i përgatit materiale mësimore etj. E rëndësishme është që mësuesi ndihmës të kontribuojë në përfshirjen e nxënësit të tij me AN në klasë, që ai të progresojë në prani të shokëve dhe mësuesve dhe jo të rrijë i veçuar. Strategjitë praktike që janë funksionale për një nxënës me AN mund të mos jenë për një nxënës tjetër dhe pse ata mund të kenë të njëjtën diagnozë. Secili nxënës ka aftësitë e tij individuale. Ndaj duke njohur mirë se çfarë nxënësi mund të bëjë ne mund të përzgjedhim për të ato strategji që janë më efektive për të. Por nuk ka ndarje me thikë, bardhë e zi, mund të ketë edhe ndërthurje të disa strategjive praktike njëkohësisht për arritjen e suksesit në punën me nxënësit me AN.

Familja dhe komuniteti janë partnerët që e ndihmojnë shkollën të arrijë suksesin e dëshiruar me këta nxënës.

Por punonjësit arsimorë duhet të marrin në konsideratë se prindërit janë ata që duhet të marrin pjesë në vendimmarrje të përbashkëta me shkollën dhe për këtë arsye ata duhet të njohin mire fazat nëpër të cilat kalohet deri në arritjen e bashkëpunimit me ta. Ata duhet të dinë se faza e parë kur prindërit kanë nevojë për mbështetje është faza e diagnostikimit dhe e vlerësimit të situatës nga profesionistët. Shumë prindër e kanë të vështirë ta pranojnë faktin që fëmija i tyre ka nevojë për vlerësim. Në fazën pasardhëse që është pikërisht ajo pasi fëmijës i është bërë vlerësimi nga profesionistët, ka plot raste në të cilat prindërit nuk e pranojnë faktin që fëmija i tyre është identifikuar me aftësi të kufizuara. Dhe në fazën e tretë ata ndjehen të zemëruar e të nevrikosur dhe në të shumtën e rasteve fajësojnë veten për situatën. Kjo është dhe faza më e vështirë për bashkëpunimin mësues-prind. Mësuesi në këtë fazë duhet të tregohet fleksibël dhe empatik dhe duhet ta konsiderojë si pjesë të procesit të pranimi dhe të mos e marrë si diçka personale acarimin, frustimin dhe mbylljen në vetvete të prindërve. Dhe nëse prindërit arrijnë në akuza të drejtpërdrejta ndaj mësuesit duke i thënë atij se nuk ka punuar sa duhet me fëmijën e tij, mësuesi duhet të tregohet i kujdesshëm duke evituar vetëmbrojtjen dhe acarimet e mëtejshme. Por ndodh që në fazën e katërt, ka

prindër që vetë ata kalojnë situata shumë të vështira. Ata pushtohen nga ndjenja e turpit, e përgjegjësisë, e fajit, e humbjes dhe e mungesës së shpresës, ndjenja të cilat i çojnë prindërit deri në kufijtë e depresionit. Dhe faza e fundit, është faza e pranimi të faktit nga ana e prindërve që fëmija i tyre ka aftësi të kufizuara. Dhe zakonisht ky është momenti i vendosjes së bashkëpunimit dhe partneritetit të shëndetshëm të prindërve me shkollën dhe mësuesin. Mësuesi duhet të ndihmojë prindërit të arrijnë një balance mes shpresës dhe realitetit. Jo domosdoshmërisht, të gjithë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, kalojnë në fazat e mësipërme, por mësuesi duhet të jetë i parapërgatitur për çdo situatë të mundshme (Manual, Tiranë, 2014).²⁰

Por dhe komuniteti luan rol të rëndësishëm për mbarëvajtjen e shkollës. Partneriteti shkollë-komunitet evidentohet te plotësimi i nevojave të tyre në mënyrë të ndërsjelltë sipas mundësive që kanë dhe asaj që mund të ofrojnë. Shkolla bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxëniet e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

Shkolla, familja dhe komuniteti punojnë së bashku:

- për të ndërtuar strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet
- për të pasuruar dhe nxitur përmes veprimtarive formale dhe jo formale
- për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime për shkollën, familjen dhe komunitetin.²¹

Shkolla ka qenë gjithmonë e hapur për bashkëpunimin me komunitetin dhe familjet e nxënësve, kjo falë dhe drejtuesve të shkollës që e kanë kthyer partneritetin shkollë-familje-komunitet në pjesë të kulturës institucionale duke e mbështetur punën e tyre te standardet e drejtimit dhe më konkretisht te standardi i pestë “Drejtimi i shkollës në partneritet me prindërit dhe komunitetin e gjerë”²² (Urdhër, nr.477, datë 30.09. 2019, f. 8)

²⁰ Manual “Jam mes jush, i ngjashëm, i ndryshëm, i barabartë” World Vision, Tiranë 2014, f.114-115.

²¹ Udhëzues për Shkollat Qendra Komunitare, IZHA dhe Save the children, tetor 2014, f. 8.

²² “Standardet profesionale për zhvillimin e drejtorëve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar” (Urdhër, nr.477, datë 30.09.2019), f. 8.

Meqenëse nxënësit me AN shfaqin probleme dhe në zhvillimin e tyre gjuhësor le të përmendim disa tipe kryesore të vështirësisë së gjuhës dhe komunikimit.

Vështirësitë e gjuhës dhe komunikimit te fëmijët shfaqen në forma të ndryshme dhe kanë karakteristikat e tyre specifike. Përmendim:

1. *Vështirësitë gjuhësore:*

Kryesisht këto vështirësi kanë të bëjnë me dëmtime gjuhësore kur fëmija shfaq paaftësi për të shprehur idetë, mendimet apo nevojat e tij, gjithashtu mund të shfaq vështirësi për të kuptuar se çfarë thonë të tjerët. Pra, shprehur më shkurt, janë vështirësi e gjuhës shprehëse dhe asaj perceptuese.

Mund t'i klasifikojmë vështirësitë gjuhësore:

- a. *Vonesa e thjeshtë gjuhësore* e cila ka të bëjë me vështirësi në organizimin sintaksor dhe morfologjik të fjalisë që lidhen dhe me vështirësi të të kuptuarit të gjuhës. Por nuk ka të bëjë me pasjen e ndonjë forme të prapambetjes mendore, të çrregullimeve të personalitetit etj.
- b. *Afazia dhe disfazia* ka të bëjë me vështirësitë në komunikim, humbjen e aftësive gjuhësore të fituara dhe mund të shfaqet si rezultat i goditjeve apo lëndimeve të trurit. Fëmijët shfaqin vështirësi të gjuhës së shprehur. Të dy termat e lartpërmendur i referohen humbjes së plotë ose të pjesshme të aftësive komunikuese verbale. Për nga natyra është forma më e rëndë dhe më serioze e vonesës së gjuhës, por nuk duhet ngatërruar me vonesën e thjeshtë të gjuhës. Si tipar kryesor i kësaj vështirësie është pamundësia për të kuptuar gjuhën dhe për ta folur atë.
- c. *Mutizmi* është zhdukja e gjuhës tek një fëmijë, i cili e ka pasur të zhvilluar më parë aftësinë për të folur. Mutizmi mund të shfaqet i plotë ose i pjesshëm. Është i plotë kur fëmija nuk flet. Kjo gjendje mund të zgjasë disa javë, por dhe më tepër. Shumicën e rasteve shkaktohet nga një ngarkesë e madhe emocionale për fëmijën, e shkaktuar nga një situatë dhune, ndarjeje, vdekjeje etj.) Mutizmi i pjesshëm mund të shfaqet jashtë familjes, zakonisht në momentin e fillimit të shkollës. Fëmija nuk flet as me shokët dhe as me mësuesit e tij. Izolohet brenda vetes. Mutizmi mund

të shoqërohet me agresivitet kur përpigemi ta detyrojmë me forcë fëmijën që të flasë.

2. Vështirësitë në komunikim

Këto vështirësi kanë të bëjnë me qartësinë e të folurit, rrjedhshmërinë e të folurit apo cilësinë e zërit. I klasifikojmë në veështirësi: *a. të artikulimit, b. apraksia, c. vështirësi në rrjedhshmërinë e komunikimit, d. që lidhen me zërin.*

- a. Ka të bëjë me paaftësinë e fëmijës për t'i formuar apo lidhur tingujt, shkronjat ose rrokjet, pra ka të bëjë me dëmtimin e të folurit. Fëmija thotë një shkronjë për një tjetër, i keqshqipton tingujt, deformon fjalët duke lënë jashtë duke mos i përfshirë në të shkronja ose rrokje etj.
- b. Ka të bëjë me gabimet në të folur, pra lidhet me aspektin motor të komunikimit. Fëmija arrin të kuptojë më shumë se sa ai flet. E folura e tij mund të jetë dhe e pakuptueshme. Mund të jetë e lindur, ose shkaktohet nga faktorë të jashtëm, si: lëndime në kokë, goditje, tumore etj. Fëmija e di se çfarë duhet të thotë, por truri i tij e ka të vështirë t'ia japë komandën lëvizjes së muskujve përgjegjës për t'i thënë ato fjalë.
- c. Ka të bëjë me dëmtimet e të folurit, ndërprerje në rrjedhën apo ritmin e thënies së fjalëve apo fjalive dhe për pasojë nxënësi mund të përsërisë, zgjasë tingujt, rrokjet, fjalët etj. Pra, marrja e gojës ka të bëjë zakonisht me shpejtësinë dhe ritmin e të folurit. Marrja e gojës, ose belbëzimi përfshin përsëritjen e fjalëve, të tingujve, të rrokjeve, hezitimin për të folur, apo pengesat, bllokimet kur fëmijët flasin. Kjo ndodh për shkak se fëmijës i vijnë idetë dhe mendimet në mendje më shpejt sesa aftësia e tij për t'i shprehur ato. Ka disa fëmijë që belbëzojnë nga stresi, lodhja, acarimi etj. apo kur një fëmijë është nën presion.
- d. Ka të bëjë me dëmtime të të folurit dhe kryesisht me një zë jo të zakonshëm, si p.sh. zë shumë i lartë ose i ulët, që ndërpritet nga pauza të gjata etj.; probleme të cilësisë së zërit, si p.sh. i çjerrë, i ngjirur, i ashpër, shumë i butë etj.; probleme që kanë të bëjnë me intensitetin e zërit etj.

Një nga motot kryesore që ka çdo institucion arsimor parauniversitar në vendin tonë është “*një shkollë miqësore për të gjithë*” nismë kjo e iniciuar

në Shkollat Qendër Komunitare²³ (Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare, 2014, f.5) e cila nënkupton një shkollë të hapur, me marrëdhënie reciprociteti midis të gjithë aktorëve përkatës të cilët japin dhe marrin nga njëri-tjetri, plotësojnë nevojat dhe interesat e njëri-tjetrit, por prioritet i të gjithë aktorëve, grupeve të interesit është *nxënësi*. Interesi i përbashkët i të gjithë aktorëve është aftësimi i tij për jetën, për t'u përballur me sfidat e së ardhmes duke u bërë një qytetar i denjë për shoqërinë. Dhe për nxënësit me AN prioritetet janë po ato si për të gjithë nxënësit e tjerë. Gjithashtu rol kyç në këtë aspekt ka drejtimi i shkollës të cilin e shohim të pasqyruar te Standardi V, “Drejtimi i institucionit në partneritet me prindërit dhe komunitetin e gjerë”, Dimensioni 5A “Partneriteti si pjesë e misionit dhe e vizionit të institucionit.” dhe Dimensioni 5D “Institucioni arsimor, familja dhe angazhimi i komunitetit”²⁴(Urdhër, nr.477, datë 30.09. 2019, f.14). Prandaj forcimi i bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet është çelësi i suksesit për integrimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve me AN. Rol të rëndësishëm në partneritet luajnë dhe organet kolegjiale brenda shkollës, si: Bordi i shkollës, Këshilli i prindërve, Qeveria e nxënësve të cilat janë në funksion të rritjes së bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet.

Mësuesit dhe prindërit në unison me njëri-tjetrin duhet të njohin mire personalitetin e fëmijës në tërësi, në procesin e llojeve konkrete të veprimtarisë së tij, në marrëdhëniet e ndërsjella me shokët, me të rriturit, me familjarët në shtëpi etj.²⁵ (Bregu Maliq, 2020, f.48.)

Përfundime:

“Një shkollë miqësore për të gjithë”- është motoja e suksesit për të gjithë nxënësit, por veçanërisht për nxënësit me aftësi ndryshe (AN). Mbështetja e tyre nga të gjithë aktorët në shkollë, trajtimi i tyre me dinjitet, gjithëpërfshirja e tyre, mosbullizimi nëpërmjet përjashtimit, përçmimit apo talljes, janë disa

²³ “Standardet e shkollës si qendër komunitare”, Insituti i Zhvillimit të Arsimit, Tiranë 2014, f. 5.

²⁴ “Standardet profesionale për zhvillimin e drejtorëve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar” (Urdhër, nr.477, datë 30.09.2019), f. 14.

²⁵ Bregu Maliq, “Mësimi dhe edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara”, Botimet M&B, Tiranë 2020, f.48.

nga faktorët kryesorë që ndikojnë në progresin akademik dhe emocional të nxënësve me AN duke bërë të mundur mirëqenien e tyre. Dashuria dhe përkushtimi ndaj këtyre nxënësve bën që ata të ndihen të barabartë me nxënësit e tjerë, stimulon tek ata dëshirën për të mësuar, për t'u gjithëpërfshirë në aktivitete të ndryshme, për t'u bërë më social dhe për t'u ndier të dobishëm në shoqëri. Sjelljet pozitive ndaj nxënësve me AN ndikojnë që ata të kenë më tepër vetëbesim dhe të ndihen dikushi në jetë. Përveç aktorëve të lartpërmendur duhet që instancat përkatëse sipas hierakisë shtetërore të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme si dhe të hartojnë strategji, programe dhe projekte që u vijnë në ndihmë nxënësve me AN duke ndikuar që ata të marrin suportin dhe mbështetjen e duhur. Do të ishte mirë që të zhvilloheshin trajnime sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere me prindër, nxënës, mësues, anëtarë të komunitetit etj. Për trajtimin, integrimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve me AN në shkolla. Të gjithë bashkë si një trup i vetëm: nxënës, mësues, psikolog apo punonjës social, prindër dhe institucione shtetërore do të bëjnë të mundur mbështetjen e plotë të nxënësve me AN duke realizuar misionin fisnik të përgatitjes së njerëzve të qytetëruar dhe të përgatitur për të përballuar me sukses çdo sfidë që jeta u ofron.

Do të donim që këtë punim ta përmbyllim me një ese të krijuar nga vetë ne për fëmijët me aftësi ndryshe:

“Erdhe në jetë ashtu si çdo fëmijë tjetër: i pafajshëm në një botë të panjohur. Por jeta shpesh është e padrejtë, nuk ua ofron shanset të gjithëve njëjloj. Duke kaluar ditët, muajt dhe vitet ti kupton se jeta të ka përballur me sfida të mëdha, sfida që vetëm ti mund t'i kuptosh. Fillimisht ti fillon të distancohesh, të mbyllesh në vetvete, të ndihesh fajtor pa pasur asnjë faj. Kupton se diçka të bën të jesh ndryshe nga të tjerët e kjo fillon të të mendoj, të të bëj nervoz e shpeshherë të bën pesimist. Por jo! Ti nuk dorëzohesh! Sepse ti nuk je i vetëm në këtë përballje të vështirë. Ke një familje të mrekullueshme, e cila të jep dashuri pa kushte, ndihmë dhe përkrahje të pazëvendësueshme. E prej tyre fillon të ringrihesh. Nuk e ndien më veten të përjashtuar. Madje, fillon të ndihesh special. Dëmtimi yt fizik apo intelektual, nuk mund të mposhtë shpirtin madhështor që të karakterizon; një shpirt i butë, i paqtë e me çiltërsi që rrezaton mirësi tek gjithkush që të rri pranë. Dhe tashmë je fitimtar. Je më i fortë nga sa e kishe menduar. Ti mund të bësh mrekullira, falë ndihmës së

pakursyer, jo vetëm të familjes, por edhe të miqve, mjekëve, psikologëve dhe të çdo njeriu human që kontribuon për të ardhmen tënde. Tani je dikushi dhe ji krenar për gjithçka që munde të arrish në jetë. Jeta është e bukur; vazhdo të ecësh i sigurtë në rrugëtimin e saj, ashtu si çdo qenie tjetër njerëzore!”

BIBLIOGRAFIA

Arsimi gjithëpërfshirës në Shqipëri, studim analitik. (2013) Save the children, Tiranë.

Arsimi gjithëpërfshirës-e drejtë e secilit. (2014) Broshurë, shkurt.

Bregu, Maliq. (2020) *Mësimi dhe edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara*, Botimet M&B, Tiranë.

Gjithëpërfshirja në arsim Një përmbledhje punimesh kërkimore, mbështetur dhe zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

E drejta për arsimim. (2012) Ligji i arsimit parauniversitar, nr.69/2012, Neni 5.

Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. (2017) Ligji 18/2017 Neni 18: *E drejta për arsimim*,

Jam mes jush, i ngjashëm, i ndryshëm. (2014) *i barabartë* Manual, World Vision, Tiranë.

Standardet e shkollës si qendër komunitare. (2014), Insituti i Zhvillimit të Arsimit, Tiranë.

Standardet profesionale për zhvillimin e drejtorëve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar. (Urdhër, nr.477, datë 30. 09. 2019).

Për Shkollën Qendër Komunitare. (2014) Udhëzuesi i gjithëpërfshirjes-Shkollë miqësore për të gjithë. Mbështetur nga UNICEF, dhjetor.

Shkollat Qendra Komunitare. (2014) Udhëzues, IZHA dhe Save the children, tetor.

Për miratimin e rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. (Datë 28.01.2020) Neni 70: *Të drejtat e nxënësve.* Urdhër nr. 31.

Woolfolk, Anita. (2011) *Psikologji edukimi*, Botimi i njëmbëdhjetë, Qendra për arsim demokratik, Tiranë.

OPINIONI I GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË DHE RËNDËSIA JURIDIKO- NDËRKOMBËTARE E TIJ PËR STATUSIN E KOSOVËS

Abstract

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) jep opinion këshillues për çështjet gjyqësore që u referohen nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, lidhur me aktet ligjore të cilat bien ndesh me të drejtën ndërkombëtare.

Komisioni Badinter, i krijuar nga Komuniteti Evropian për Jugosllavinë, shprehej në korrik 1992, se me shpërbërjen e Jugosllavisë, kishte përfunduar edhe subjektiviteti juridiko-ndërkombëtar i atij shteti. Ndërkombëtarët ishin fokusuar në rikthimin e autonomisë së mëparshme të Kosovës, duke mohuar pavarësinë e saj. Me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s kundër Serbisë më 1999, kjo do ta ndryshonte gjendjen. Pas konfliktit të vitit 1999, Këshilli i Sigurimit konfirmoi autonomisë substanciale për Kosovën sipas Rezolutës 1244, administrimin e përkohshëm ndërkombëtarë të saj dhe e bëri pjesë të Rezolutës 1244 Marrëveshjen e pamiruar të Rambujesë, që vendoste për zgjidhjen me referendum të statusit.

Dokumentet ndërkombëtare parashikuan kalimin gradual të kompetencave nga institucionet ndërkombëtare tek institucionet e Kosovës. Më 17 shkurt 2008, u shpall pavarësia e Kosoves. Më 15 gusht 2008, ministri i Jashtëm i Serbisë Vuk Jeremiç kërkoi në Kombet e Bashkuara, mendimin e GJND-së nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Më 22 korrik 2010 ajo vendosi që shpallja e pavarësisë ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Sipas Gjykatës, përfaqësuesit e popullit të Kosovës, nuk ishin të limituar nga Korniza Kushtetuese e krijuar nga Kombet e Bashkuara. Opinioni këshillues i GJND-së, i hap rrugën zyrtarizimit të ekzistencës dhe njohjeve të Republikës së Kosovës dhe nuk është precedent për shqiptje të tjera të njëanshme.

Key words: *Pavarësia e Kosovës, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Opinioni, NATO, Rezoluta 1244, Marrëveshja e Rambujesë, E drejta Ndërkombëtare, etj.*

²⁶ MSc. Sajmir BATA
PhD Candidate

1. Hyrje.

Bazuar tek përcaktimet e vendosura nga Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), u themelua më 1945, dhe filloi punë në prill të vitit 1946. Ky institucion ndërkombëtar ka dhënë ndihmesë të madhe në jurisprudencën ndërkombëtare, duke qenë pjesë e rëndësishme e OKB-së. Gjykata “vepron në përputhje me Statutin e saj që është pjesë integrale e Kartës së OKB-së, dhe, si i tillë, konsiderohet një ndër aktet universale të së drejtës ndërkombëtare me vlerë të pakontestueshme” (Krisafi, Ksenofon. 2014: 186). Ndikimi i vendimeve të saj mund të jetë i rëndësishëm sidomos kur gjykata merr në shqyrtim çështje të kontestueshme të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfshihen edhe e drejta e vetëvendosjes, e shkëputjes dhe e njohjes ndërkombëtare.

Kjo gjykatë ka juridiksion të dyfishtë pasi “vendos në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për konteste të natyrës ligjore që dorëzohen nga shtetet... -si dhe jep mendime këshilluese për çështje ligjore sipas kërkesës së organeve të Kombeve të Bashkuara apo agjensive të specializuara që janë autorizuar për të bërë një kërkesë të tillë” (Bajrami, Arsim. 2014: 272).

GJND-ja përbëhet nga 15 gjyqtarë, të cilët u përkasin shteteve të ndryshme. Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit, për të qëndruar në detyrë për një afat 1- vjeçar. Gjykatës mund t’i drejtohen të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, ndërsa “... vendet që nuk janë anëtare të OKB-së, mund të jenë palë në statutin e GJND-së sipas të drejtës vetjake (neni 35(1)). Vendet që nuk janë palë në statut, mund t’i drejtohen gjykatës sipas kushteve të veçanta, të përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit (neni 35 (2)), ...” (Dixon, Martin. 2011: 374).

2. Kosova para dhënies së opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (1991-2010), dhe statusi i saj

Parimet e vendosura në periudhën e Luftës së Ftohtë ishin lëkundur nga ngjarjet që ndodhën pas mbarimit të saj, (kujtojmë këtu shpërbërjen e BRSS, ndarjen e Çekosllovakisë në dy shtete, etj). Rasti i ish-Jugosllavisë ka qenë më i ndërlikuari për t'u zgjidhur konform të drejtës ndërkombëtare, pasi bëhej fjalë për shkëputje, e cila nuk mund të zbatohet jashtë kontekstit kolonial. Por në praktikë kishte ndodhur ndryshe, Komuniteti Evropian disa javë pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kroacisë dhe Sllovenisë, kishte pranuar se Republikat e Federatës Jugosllave, të cilat dëshironin shkëputjen, mund të arrinin pavarësinë, pavarësisht nga kundërshtimet e autoriteteve qëndrore politike e ushtarake në Beograd. Në thelb, kjo do të thotë që "... e drejta e vetëvendosjes mund të shfaqet, kur e drejta e brendshme kushtetuese u ofronte mundësinë e shkëputjes një njësie konstituive të shtetit, ose kur shteti federativ është në proces të shpërbërjes." (Weller, Marc. 2011: 463).

Çfarë ndodhi me rastin e Kosovës?

Në bazë të Kushtetutës së vitit 1974 të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, Kosova kishte një status në vartësi të dyfishtë, nga një anë njësi e plotë federative dhe nga ana tjetër krahinë autonome nën ndikimin e Republikës së Serbisë, por pa vullnetin e saj.

Shtojmë këtu se edhe Komisioni Badinter, i mandatar për të këshilluar Konferencën e Paqes të Komunitetit Evropian për Jugosllavinë, kishte arritur në përfundimin se "me shpërbërjen e Jugosllavisë, proces që kishte filluar më 1991, dhe kishte përfunduar në korrik 1992, kishte përfunduar edhe subjektiviteti juridiko-ndërkombëtar i atij shteti" (Hasani, Enver. 2000: 62):

“Shpërbërja e atij shteti -(ish-Jugosllavisë)- nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare është legjitimuar ndërkombëtarisht si pasojë e faktit të ekzistencës së parimit ndërkombëtarë të vetëvendosjes (“shprehja e vullnetit të lirë”), dhe e natyrës represive të atij shteti...” (Hasani, Enver. 2000: 77).

Theksojmë se Komisioni Badinter, nuk e përmend rastin e Kosovës si entitet i autorizuar për vetëvendosje, në kuptimin e pavarësinë së plotë të saj:

“Qëllimi kryesor i shqiptarëve të Kosovës për të zvogëluar dhunën ishte: jo hakmarrje, monitorim i të drejtave të njeriut, dhe ekspozimi ndërkombëtar -i çështje së tyre-” (Clark, Hoawrd. 2000: 140).

Nëse shikojmë me vëmendje përpjekjet e ndërkombëtarëve lidhur me zgjidhjen e krizës në Kosovë deri në shpërthimin e dhunës gjithëpërfshirëse në vitin 1998, ato ishin fokusuar në rikthimin e autonomisë së mëhershme të Kosovës, duke u mohuar dukshëm pavarësia e saj. Edhe nga pikëpamja juridike, situata nuk kishte ndryshime shumë që nga viti 1991, kur kishte filluar shpërbërja e Jugosllavisë.

Aksioni i armatosur i NATO-s në Kosovë kundër Jugosllavisë më 1999, sigurisht që do ta ndryshonte gjendjen. Më e pakta UNMIK-u e kishte marrë nën administrim të përkohshëm Kosovën, i vendosur për të krijuar një vetëqeverisje lokale, duke e bërë kështu pavarësinë për shqiptarët një mundësi të pashmangshme. Represioni i vazhdueshëm serbo-sllav ndaj shqiptarëve ishte një tjetër shtysë e fuqishme që duhej të merrej në konsideratë në të drejtën ndërkombëtare, për t’i dhënë përgjigje çështjes së shtruar për zgjidhje, se pse tani Kosova kishte të drejtën për t’u bërë shtet.

Këshilli i Sigurimit (KS) në shqyrtimet që i kishte bërë krizës së Kosovës përpara konfrontimit të armatosur më 1999, kërkonte një marrëveshje të negociuar, e cila do të siguronte një vetëqeverisje të gjerë dhe përmbajtësore për Kosovën, duke respektuar integritetin territorial të RFJ-së (Rezolutat 1160

dhe 1199 të KS). Po kështu edhe Marrëveshja e Rambujesë në shkurt të vitit 1999, parashikonte së paku një periudhë kalimtare dhe më pas kriza e Kosovës të mund të shqyrtohej sërish. Tashmë pas konfliktit të vitit 1999, kur forcat serbe shkaktuan zhvendosjen masive të shqiptarëve, Këshilli i Sigurimit mori disi një qëndrim tjetër.

Në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, afirmohej përkushtimi i të gjithë shteteve anëtare ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federative të Jugosllavisë, dhe shteteve të tjera në rajon, siç është përcaktuar në aktin përfundimtar të Helsinkit. Konfirmimi i autonomisë substanciale, duke mbajtur parasysh Marrëveshjen e Rambujesë dhe integritetin territorial të RFJ-së në Rezolutën 1244, përfshin dhe anekset 1 dhe 2, që u referohen periudhës së administrimit të përkohshëm.

Në pjesët operative të Rezolutës, pavarësia nuk ndalohet shprehimisht. Lidhur me referencën që i bëhet marrëveshjes së Helsinkit, në drejtim të integritetit territorial, në preambulën e Rezolutës 1244 (1999) është jo specifike, megjithëse edhe Akti i Përgjithshëm i Helsinkit e përmban një balancë të së drejtës për integritetin territorial, dhe parimeve të tjera, përfshirë edhe të drejtat e njeriut e vetëvendosjen.

Dokumentet ndërkombëtare për Kosovën kanë parashikuar kalimin gradual të kompetencave nga institucionet ndërkombëtare tek institucionet e Kosovës, të dala nga zgjedhje të lira. Shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008, nuk ishte e njëanshme, por në bashkëpunim me ndërkombëtarët, pas një procesi të gjatë e të pranuar edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Plani i Ahtisaarit, por edhe Kushtetuta e Kosovës, i mbrojnë pakicat serbe. Shpallja e pavarësisë së Kosovës, nuk është një precedent i rrezikshëm, por një element më tepër për stabilitetin në rajon e më gjerë. Të drejtat e njeriut

mbrohen, dhe procesi i parashikuar nga Rezoluta 1244 është përmbyllur me sukses, sovraniteti dhe integriteti i Jugosllavisë (Serbisë), janë në preambulën e Rezolutës 1244 (që nuk ka efekt detyrues por deklarativ), gjithashtu kjo Rezolutë e ka bërë pjesë të saj Marrëveshjen e Rambujesë, që parashikon referendum për të zgjidhur statusin e Kosovës.

3. Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën.

Çështja e pavarësisë së Kosovës u mor për gjykim nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, pas kërkesës që bëri më:

“15 gusht 2008 ministri i Jashtëm i Serbisë Vuk Jeremiç... në Kombet e Bashkuara, duke kërkuar mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me objekt ‘A është shpallja e pavarësisë së njëanshme nga Intitucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare’.” (Bajrami, Arsim. 2014: 272-273).

Në shtator të vitit 2008, Serbia e zënë ngushtë dhe pa patur asnjë mundësi që ta pengonte procesin e njohjes ndërkombëtare dhe konsolidimit të pavarësisë së Kosovës, ndoqi rrugën e sfidimit të legjitimitetit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës të 17 shkurtit të vitit 2008. Në të vërtetë, Serbia sponsorizoi një Rezolutë të veçantë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, nëpërmjet së cilës kërkohej nga GjND-ja një mendim këshilldhënës.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, pasi e diskutoi gjërësisht projektrezolutën, e miratoi kërkesën e Serbisë “me anë të një Rezolute ku i kërkoi Gjykatës që të shprehej, nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës përbënte shkelje të së drejtës ndërkombëtare.” (Krisafi, Ksenofon. 2014: 192). Duhet theksuar se pranimi i kërkesës së Serbisë për ta gjykuar GjND-ja, do të kishte efektet e veta në frenimin e procesit të njohjes së pavarësisë së Kosovës, nga shtete të cilat nuk e kishin njohur gjer atëherë.

Sipas Ambasadorit të Serbisë në Francë, Dushan Batakoviq, Serbia argumentonte para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë se:

“Shpallja e pavarësisë së Kosovës shkelte të drejtën ndërkombëtare, ishte e njëanshme, binte ndesh me Rezolutën 1244 (1999), çënonte sovranitetin dhe integritetin e Serbisë, si dhe do të ishte precedent i rrezikshëm...” (Bajrami, Arsim. 2014: 275-276).

Në tërësinë e vet, konkluzionet e Serbisë dhe të përkrahësve të saj, mbështeteshin në të drejtën klasike ndërkombëtare të kohës së Luftës së Ftohtë, kur kombet dhe shtetet konsideroheshin sovrane, dhe ndalohej çdo ndërhyrje në sovranitetin e shteteve të tjera. Duhet të theksojmë se:

“Serba e kishte pranuar legjitimitetin e kësaj gjykate ‘në procesin mbi ligjshmërinë e përdorimit të forcës -ndaj NATO-s-...’ ndërkohë që në të njëjtën kohë, synonte të përjashtonte juridiksionin për ngjarjet që çuan në këto sulme ajrore” (Dixon, Martin. 2011: 391).

Edhe Kosova paraqiti përpara GJND-së argumente të cilat kishin të bënin me paqen, sigurinë, vullnetin e popullit të Kosovës dhe liritë e të drejtat e njeriut. Argumentet historiko-kushtetuese të paraqitura nga Republika e Kosovës, kishin të bënin me faktin që Kosova iu bashkua Serbisë në mënyrë të dhunshme dhe jo me vullnetin e popullit të saj. Këtë e tregon Rezoluta e Bujanit e vitit 1944, ku shqiptarët shpallën të drejtën e vetëvendosjes, si dhe Kuvendi i Prizrenit e Ligji i vitit 1945, për aneksimin e pavullnetshëm të Kosovës nga Serbia.

Është theksuar si argument kushtetues nga Serbia se, bashkimi i vullnetshëm i popujve të Jugosllavisë, ka qenë kusht që të ekzistonte Jugosllavia Federative dhe se në momentin kur ky shtet u shpërbë në fillim të viteve 90, ipso jure delegon këtë vendimmarrje tek populli dhe institucionet e Kosovës. Kushtetuta e vitit 1974 pranonte se Kosova ishte element konstituiv i Federatës Jugosllave dhe se kishte të drejtën e vetos ndaj kushtetutës e ligjeve

federative, por pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës nuk mund të bëheshin ndryshime kushtetuese, ndryshime kufijsh, apo veprime të tjera që preknin interesat e saj.

Sipas përfaqësuesve të Kosovës paraqitur para GjND-së, pavarësia e shpallur prej institucioneve të saj, ishte në përputhje me vullnetin e popullit dhe:

“e pakthyeshme, ... për hir të paqes dhe sigurisë së rajonit; Pas shkeljes së të drejtave njërëzore të shqiptarëve të Kosovës, Serbia humbi të gjitha të drejtat mbi këtë vend; Vullneti i popullit të Kosovës -ishte i qartë- kur Rezoluta 1244 e -KS-... i referohej qartë marrëveshjes së Rambujesë. Gjatë- negociatave për statusin final Serbia- u tregoi qartë shqiptarëve se nuk ishte e interesuar për gjetjen e zgjidhjes...” (Bajrami, Arsim. 2014: 276).

Edhe Shqipëria paraqiti argumentet e saj përpara GjND-së lidhur me shpalljen e pavarësinë së Kosovës, ku theksohej se:

“1. Nuk ka asnjë rregull në të drejtën ndërkombëtare që ndalon shkëputjen; ...” (Barbullushi, Gazmend. <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15618>).

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shqyrtoi nëse ishte shkelur integriteti territorial i ndonjë shteti, me shkëputjen dhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës, dhe nëse ishte pavarësia e Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Gjykata “... analizoi me hollësi rrethanat përkatëse që çuan në pavarësinë e Kosovës, dhe pasi interpretoi me autenticitetin e duhur juridik thelbin e strukturave bazë të korpusit themelor të së drejtës ndërkombëtare, miratoi një vendim këshillimor...” (Krisafi, Ksenofon. 2014: 189).

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, vendosi më 22 korrik 2010, se:

“Shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Kryetari i GjND-së, gjykatësi Hisashi Owada, tha se e drejta ndërkombëtare nuk përmbante ‘asnjë dispozitë me të cilën ndalohet shpallja

e pavarësisë së Kosovës. Përkundrazi GJND-ja konstaton se pavarësia është shpallur në përputhje me të drejtën ndërkombëtare... -dhe se- përfaqësuesit e popullit të Kosovës, nuk ishin të limituar nga Korniza Kushtetuese e krijuar nga Kombet e Bashkuara...” (Bajrami, Arsim. 2014: 279).

Owada qartësoi përfundimisht edhe mendimin e gjykatës lidhur me pretendimet e Serbisë, dhe mbështetësve të saj, se pavarësia e Kosovës nuk është shpallur në kundërshtim me rezolutën 1244 (1999), të Këshillit të Sigurimit, të OKB-së, duke theksuar se kjo rezolutë është nxjerrë me qëllim që t’i jepet fund pushtetit të Serbisë në Kosovë. Ajo parashikon administrimin e përkohshëm ndërkombëtarë të Kosovës prej UNMIK-ut, i cili kishte për detyrë të ndihmojë në krijimin dhe forcimin e institucioneve vendore:

“Gjykata konstatoj se shpallja e pavarësisë, gjithnjë dhe detyrimisht do t’i shmanget rendit juridik nga i cili kërkon të shkëpusë entitetin që shpall pavarësinë... Gjykata konsideron se autorët e Deklaratës së shpalljes së pavarësisë, nuk vepruan, dhe as nuk kishin qëllim të vepronin, në cilësinë e një institucioni të krijuar apo të shfuqizuar, që vepronte brenda këtij rendi juridik, por ishin nisur ta miratonin një masë, rëndësia dhe efekti i të cilës, do të shtriheshin jashtë këtij rendi” (Weller, Marc. 2011: 489).

4. Rëndësia juridiko-politike e Opinionit këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Opinionit këshillues i GJND-së, solli njohjet e mëtëjshme ndërkombëtare për Kosovën. Serbia nuk e njohu këtë opinion, sepse sipas saj, ishte shkelur e drejta e integritetit dhe sovranitetit. Ky opinion “i hap rrugën... zyrtarizimit të ekzistencës së shtetit të dytë shqiptar, Republikës së Kosovës, ... Kosova mori një afirmim juridiko-ndërkombëtar të kualifikuar në mënyrën më të pakontestueshme, e mori atë nga instanca më e lartë gjyqësore ndërkombëtare, nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë” (Krisafi, Ksenofon. 2014: 186).

Për më tepër:

“Vendimi i Hagës i jep fund alibisë së shpërndarë me një frekuencë të shumëfishuar nga Beogradi, mbi gjoja shkeljen e së drejtës ndërkombëtare nga vendimi i 17 shkurtit të 2008, ... Duke dashur të pengojë daljen dhe afirmimin e Kosovës si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, ... politikat e Beogradit mbështeteshin mbi një nga teoritë më të kontestuara juridike, mbi teorinë konstitutive të njohjes. Sipas saj, është njohja ndërkombëtare ajo që e krijon, që e konstituon, një entitet, si subjekt të së drejtës ndërkombëtare” (Krisafi, Ksenofon. 2014: 188-189).

Faktet dhe Opinioni i GJND-së provojnë se pavarësia e Kosovës është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. GJND-ja, konkludon se nuk mund të pranohen argument, se Rezoluta 1244, parashikon ndalimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Rezoluta 1244, mbron integritetin dhe sovranitetin e Jugosllavisë, por le të hapur mundësinë e zgjidhjen e statusit të Kosovës (kjo vërehet edhe në përmbajtjen e saj, duke e bërë pjesë të saj Rambujenë, e cila parashikonte zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës me referendum). Kosova nuk është precedent për shkëputje të tjera të njëanshme si (Abkhazia dhe Osetia Jugore nga Gjeorgjia). Kosova i plotëson kushtet për të shpallur pavarësinë dhe për të qenë shtet, pasi ka territorin, popullsinë, dhe qeverinë e saj, dhe ka marrë shumë njohje pas shpalljes së pavarësisë dhe Opinioni të GJND-së. Edhe Kushtetuta e vitit 1974, shprehej në nenin 5 të saj, se territori dhe kufijtë e Kosovës s’mund të ndryshohen pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës, dhe se Rezoluta 1244, Korniza Kushtetuese, njohin statusin e përkohshëm të Kosovës, dhe nuk e pengojnë zgjidhjen përfundimtare të tij drejt pavarësisë. Shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, është një realitet i faktuar.

Përfundime

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), u themelua bazuar tek Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe jep opinion këshillues për çështjet gjyqësore që i referohen nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, lidhur me aktet ligjore që bien ndesh me të drejtën ndërkombëtare.

Lidhur me rastin e Kosovës, Komisioni Badinter i krijuar nga Komuniteti Europian, për Jugosllavinë, kishte arritur në përfundimin se me shpërbërjen e Jugosllavisë më 1992, kishte përfunduar edhe subjektiviteti juridiko-ndërkombëtar i atij shteti. Nëse shikojmë me vëmendje përpjekjet e ndërkombëtarëve lidhur me zgjidhjen e krizës në Kosovë, deri në shpërthimin e dhunës gjithëpërfshirëse në vitin 1998, ishin fokusuar në rikthimin e autonomisë së mëparshme, duke u mohuar pavarësia e Kosovës.

Aksioni i armatosur i NATO-s kundër Jugosllavisë më 1999, sigurisht që do ta ndryshonte gjendjen. Gjithashtu pas konfliktit të vitit 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, me Rezolutën 1244 (1999), afirmonte sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federative të Jugosllavisë, njëhte autonominë substanciale të Kosovës, si dhe mbante parasysh Marrëveshjen e Rambujesë.

Dokumentet ndërkombëtare për Kosovën kanë parashikuar administrimin e përkohshëm ndërkombëtarë të Kosovës dhe kalimin gradual të kompetencave nga institucionet ndërkombëtare tek institucionet e Kosovës, të zgjedhura me zgjedhje të lira, si fazë kalimtare drejt zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës. Shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008, nuk ishte e njëanshme por pas një procesi të gjatë dhe të pranuar edhe nga institucionet ndërkombëtare. Plani i Ahtisaarit, por edhe Kushtetuta e Kosovës, i mbrojnë pakicat serbe. Shpallja e pavarësisë nuk është një

precedent i rrezikshëm, por një element më tepër për stabilitetin në rajon dhe më gjerë.

Çështja e pavarësisë së Kosovës, u mor në gjykim nga GJND-ja, pas kërkesës që bëri më 15 gusht 2008 ministri i Jashtëm i Serbisë Vuk Jeremiç në Kombet e Bashkuara, duke kërkuar mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nëse shpallja e pavarësisë së Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë më 22 korrik 2010 vendosi se: shpallja e pavarësisë së Kosovës është shpallur në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe se përfaqësuesit e popullit të Kosovës, nuk ishin të limituar nga Korniza Kushtetuese e krijuar nga Kombet e Bashkuara. Sipas saj, Rezoluta 1244 e Këshilli të Sigurimit, mbron integritetin dhe sovranitetin e Jugosllavisë, por le të hapur mundësinë e zgjidhjes së statusit të Kosovës. Opinioni këshillues i GJND-së solli njohjet e mëtejshme ndërkombëtare për Kosovën dhe i hapi rrugën zyrtarizimit të ekzistencës së Republikës së Kosovës.

Bibliografia

Bajrami, Arsim. (2014) *Historia e Konstitucionalizmit Shqiptar 1912-2012*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta CXXXIX, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Libri 48, Shtypi: Focus Print Shkup, Prishtinë.

Bajrami, Arsim. (2021) *Shtetndërtimi i Kosovës 1990-2020*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të Veçanta, CC, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Libri 66, Prishtinë.

Clark, Howard. (2000) *Civil Resistance in Kosovo*, Pluto Press LONDON•STERLING, VIRGINIA.

Dixon, Martin. (2011) *Textbook an International Law* (translate: Shpëtim Çuçka, Tianda Kaçi (Çuçka), E drejta ndërkombëtare), Tirana Times, Tiranë.

Hasani, Enver. (2000) *Shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe Kosova, Aspekte politiko-juridike*, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë 2000. <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15618>.

Krisafi, Ksenofon. (2014) *Për tokën dhe detin e Shqipërisë*, UETPRESS, Tiranë.

Weller, Marc. (2011) *Shtetësia e kontestuar, Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, “Koha”, Prishtinë.

PROCESI I RREGULLT LIGJOR NË PROCESIN E RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Abstract

The Assembly of Albania, with Decision 96/2014, created a Special Parliamentary Commission for Reforming Judicial System, with the aim of analyzing the situation, determining the objectives of the justice reform, as well as proposing the necessary constitutional and legal changes. Following this initiative, on July 22, 2016, the Assembly adopted unanimously the Constitutional Law no. 76/2016, which, *inter alia*, provided re-evaluation process for all judges, prosecutors, KLD inspectors, as well as legal advisers and assistants. The re-evaluation process was established in order to guarantee the functioning of the rule of law, the independence of the justice system, as well as to restore public trust in the institutions of this system. This paper analyzes the process of re-evaluation of judges and prosecutors in the light of the principle of due process as foreseen in constitutional and international standards. The paper focuses specifically on the Law 84/2016 and aspects of the application of the principles of due process in the re-evaluation process in the light of European Convention Human Rights Court practice.

Keywords: *due process; re-evaluation, judges, prosecutors, the independence of the judiciary system*

²⁷ Vojsava OSMANAJ Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit,
Shkodër
Shqipëri

1. Hyrje

Asnjë shtet modern nuk mund të bëjë pa një gjyqësor, por kjo nuk do të thotë se gjyqësori është gjithmonë i dashur dhe i vlerësuar nga ana e popullit që është sovran. Pushteti gjyqësor është njëri nga pushtet kryesore të shtetit demokratik e kushtetues, funksioni i tij në mënyrë të pavarur dhe me integritet është një premisë e pashmangshme për demokracinë dhe kushtetutën e një shteti, duke vepruar me paanshmëri, siguruar parimin e shtetit të së drejtës dhe balancimin e pushteteve. Një zgjidhja e drejtë dhe efektive e mosmarrëveshje kërkon detyrimisht një gjykues të drejtë e të pavarur nga interesat dhe pozicionet e palëve në mosmarrëveshje. Magjistrati që ushtron funksion duhet të ketë garancitë e qëndrimit (parimi i patundshmërisë) dhe integritet në ushtrimin e funksioneve.

Parashikimi i shkaqeve për lëvizjen e gjyqtarëve ose prokurorëve është pasojë e mungesës së cilësive themelore që duhet të kenë anëtarët e pushtetit gjyqësor në ushtrimin e rregullt të funksioneve që u janë besuar atyre nga kushtetuta. Parimi i pavarësisë dhe integritetit të pushtetit gjyqësor, nuk është një e drejtë apo privilegj i magjistratit, por një e drejtë e pushtetit gjyqësor që duhet t'i shërbejë respektimit të të drejtave themelore të çdo personi që kërkon drejtësi pranë pushtetit gjyqësor.

Parimi i patundshmërisë së magjistratit ka disa përjashtime, nëse dhe vetëm në ato raste, kur vërtetohet se magjistrati nuk ka respektuar cilësitë themelore për ushtrimin e rregullt të profesionit të tij dhe është i përgjegjshëm. Pasojë e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, është vërtetimi dhe eventualisht shkarkimi i anëtarit të pushtetit gjyqësor që ka shkaqe për mos ushtrimin e rregullt të funksionit gjyqësor. Nëse ka baza të forta që të bëjnë të besosh se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore.

Meqenëse, procesi që ka të bëjë me shkarkimin e magjistratit, përbën një përjashtim nga parimi i patundshmërisë nga funksioni i magjistratit, është e nevojshme që organet, procedura, rastet e shkarkimit dhe të drejtat e magjistratëve, të jenë të përcaktuara në mënyrë sa më të qartë, duke përbërë qoftë garanci nga abuzimi me këto procedura që mund t'i bëhen ndaj magjistratëve nga subjekte të ndryshëm, qoftë edhe për të shmangur ndërhyrjen në ushtrimin e pushtetit gjyqësor të pavarur nga pushtetet e tjera. Rastet e shkarkimit nga detyra si sanksion për magjistratin duhet të jenë, jo vetëm të përcaktuara saktë, por edhe të vërtetuara mbi bazën e një procedure të drejtë e të rregullt që duhet të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare të procesit të rregullt. Në të kundërt nuk do të mund të sigurohet pavarësia e gjyqësorit dhe patundshmëria e gjyqtarit.

E drejta për një proces të drejtë përbën një nga të drejtat themelore të njeriut. Ajo është ndër të parat të drejta subjektive që u janë njohur në favor të individëve me qëllim për të realizuar të drejtat e tyre thelbësore. Në kuadër të sistemeve të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, e drejta për një proces të rregullt ka dy karakteristika: nga njëra anë, ajo është një e drejtë subjektive më vete; dhe nga ana tjetër, ajo përbën një instrument procedural themelor për respektimin e të gjitha të drejtave të tjera themelore.²⁸

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr. 96/2014, ka krijuar Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, me qëllim analizimin e gjendjes, përcaktimin e objektivave të reformës në drejtësi, si dhe propozimin e ndryshimeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore. Në vijim të kësaj nisme, në mënyrë unanime me datë 22 Korrik 2016, Kuvendi në cilësinë e rishikuesit të Kushtetutës, miratoi Ligjin kushtetues nr.76/2016, i cili ndër të tjerash, parashikoi si masë për reformën në drejtësi edhe

²⁸ Ledi Bianku. (2019) *E drejta për një proces të drejtë*, Tiranë, fq. 6.

procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, inspektorëve të KLD, si dhe të këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (Ligji 76/2016 ndryshuar).

Në bazë të nenit 179/B, pika “1” të Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit është ngritur me qëllim që të garantohej funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehej besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Meqenëse të drejtat dhe garancitë e gjyqtarit dhe prokurorit konsiderohen si të rëndësishme, është vlerësuar si e nevojshme, ndërhyrja në Kushtetutë për rishikimin e saj. Kështu, me ligjin për rishikimin e Kushtetutës nr.76/2016, u parashikuan kushtet e nevojshme kushtetuese për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Parashikimi në nivel kushtetues, së pari synon pranimin e gjerë të këtij procesi dhe moskundërshtimin e tij nga ana e subjekteve të interesuar. Së dyti, synon efektivitetin dhe rëndësinë e procesit të rivlerësimit si një mase të nevojshme për të luftuar korrupsionin dhe rritur besimin e publikut.

Në bazë të nenit 179/B, pika “2” të Aneksit të Kushtetutës, procesi i rivlerësimit kalimtar do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Këto të drejta dhe liri, sipas nenit 15 të Kushtetutës, janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Kushtetuta parashikon në parim se procesi i rivlerësimit do të mbështet në bazë të parimeve të procesit të rregullt, por pa e përcaktuar se cilat janë parimet që përbëjnë procesin e rregullt.

Neni B i Aneksit të Kushtetutës parashikon krijimin e një Operacioni Ndërkombëtar të Monitorimit, i udhëhequr nga Komisioni Evropian, për të mbështetur, monitoruar dhe mbikëqyrur procesin e rivlerësimit. Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejtë (i) t'i japin rekomandime Parlamentit për kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarëve të organet e rivlerësimit ose pozicioni i Komisionerit Publik, (ii) të bëjnë gjetje dhe të japin mendime për çështjet që shqyrtohen nga organet e rivlerësimit, (iii) t'i bëjnë rekomandime Komisionerit Publik për të bërë një ankesë kundër vendimit të IQC dhe (iv) aksesin dhe marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm për të monitoruar procedurat e rivlerësimit në tërësinë e tyre. Ata gjithashtu, mund të pyesin organet e rivlerësimit për të marrë prova të reja ose mund të paraqesin prova të reja për vlerësimin e tyre. Është e nevojshme që të përcaktohen përbërja dhe kuptimi i parimit të procesit të rregull, duke iu referuar si të drejtës ndërkombëtare, si të drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë që ka të bëjë me përcaktimin e të drejtave dhe primeve që rrjedhin nga procesi i rregullt.

2. Parimi i procesit të rregullt ligjor sipas standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare

Parimi i procesit të rregullt ligjor është njohur në të gjitha standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare, që zbatohen qoftë në kohë paqeje, qoftë në kohë lufte. Në bazë të nenit 179/b/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet në mënyrë eksplicite se “rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e primeve të parimit të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit.” Në bazë të kësaj dispozite rezulton qartë se parimet themelore të procesit të rregullt do të duhet të zbatohen përgjatë gjithë procedurës së rivlerësimit.

Qëllimit i nenit 179/b të Kushtetutës lidhet ngushtë edhe me ofrimin e garancive kryesore institucionale e procedurale për rivlerësimin si një proces në përputhje me Kushtetutën, duke u bazuar në parimet e procesit të rregullt dhe në atë të respektimit të të drejtave themelore dhe ofruar garancitë kushtetuese dhe ndërkombëtare në këtë fushë.²⁹ Kjo dispozitë, edhe pse nuk përcakton se cilët janë të gjithë përbërësit e procesit të rregullt, përsëri parashikon një sërë parimesh themelore për procesin e rregullt, duke filluar me parimin themelor të pavarësisë së organeve të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, guri i themelit për një proces të rregullt, duhet të fillojë me parimin e pavarësisë së organeve që do të zhvillojnë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sipas doktrinës, edhe pse ky proces rivlerësimi konsiderohet si “i jashtëzakonshëm”, përsëri nuk anashkalon parimet e ushtrimit të pushtetit gjyqësor dhe në të përmbahen garancitë procedurale.³⁰ Dy janë elementët e evidentuara nga doktrina lidhur me procesin e rregullt ligjor, natyra gjyqësore e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe e juridiksioni i tij për të vendosur mbi ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.³¹ Parashikimi i KPA si organ gjyqësor i pavarur përbën një kusht themelor për të përmbushur parimet e procesit të rregullt ligjor, duke garantuar të drejtën për një ankim efektiv përpara një gjykate të krijuar me ligj, me juridiksion si nga pikëpamja e fakteve dhe provave, ashtu edhe nga pikëpamja e elementeve të procesit të rregullt ligjor.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, kanë përcaktuar bazat dhe parimet e rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit, shkallën e kufizimit të pjesshëm të

²⁹ Aurela Anastasi. (2019) ‘Koment i nenit 179/b’ në *Komentar mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë*, Arta Vorpsi, et al (editor) (Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, ISPL fq. 461.

³⁰ po aty, fq. 464.

³¹ po aty, fq. 467.

të drejtave kushtetuese të tyre, si dhe kriteret për zbatimin dhe zbërthimin e tyre në ligjin e posaçëm, por rëndësi ka edhe mënyra se si janë zbatuar përcaktimet kushtetuese në legjislacionin e posaçëm për rivlerësim kalimtar. Pavarësisht se kushtetuta ka parashikuar disa kufizime të të drejtave kushtetuese për disa çështje të caktuara në lidhje me rivlerësimin kalimtar, asnjë kufizim nuk është bërë nga ana e ligjvënësit kushtetues dhe atij të zakonshëm për sa i përket zbatimit dhe respektit të të drejtave themelore që parashikohen nga akte ndërkombëtare, sikundër janë Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Kjo do të thotë se kufizimet në fjalë mbeten përsëri subjekt i zbatimit dhe respektimit të akteve ndërkombëtare mbi të drejtat themelore të njeriut dhe të procesit të rregullt.

Parimet përbërëse të procesit të rregullt, parashikohen shprehimisht nga neni 42 i Kushtetutës dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, siç janë neni 6 i Konventës Europiane për të drejtat e Njeriut, dhe neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Marrëveshje ndërkombëtare këto, të dyja të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Pra, kufizimet e vendosura mbi të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit duhet të jenë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të sipërpërmendura. Ndërkohë, parimet e procesit të rregullt shprehimisht nuk rezultojnë të jenë kufizuara nga Neni “A” i Aneksit të Kushtetutës.

Gjithashtu, në bazë të nenit “Ç/2” të Kushtetutës është parashikuar shprehimisht se institucionet e rivlerësimit publikojnë vendimet e tyre, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshme të marrë nga publiku. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku, duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke respektuar të drejtën për një proces të rregullt.

E drejta e mbrojtjes është një e drejtë themelore e njeriut dhe si e tillë, në parim, ajo është e pandashme, e patjetërsueshme e padhunueshme dhe qëndron në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, - duke përfshirë edhe organet e procesit të rivlerësimit- në përmbushje të detyrave të tyre- janë të detyruara të respektojnë këtë të drejtë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e saj. Kufizime të kësaj të drejtë vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, dhe ky kufizim, duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë dhe nuk mund të cenojë thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Është për t'u vënë në dukje se e drejta themelore kushtetuese për proces të rregullt nuk është parashikuar në rrethin e të drejtave të kufizuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës. Neni A është një dispozitë e cila përbën një garanci për të drejtat themelore kushtetuese të subjekteve të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit.³² Sipas doktrinës, institucionet e rivlerësimit duhet të analizojnë nëse kufizimi konkret që zbatohet është i tillë që prek vetëm pjesërisht të drejtën themelore, pa cenuar thelbin minimal dhe analiza e natyrës së kufizimit do të duhet të bëhet rast pas rasti dhe do të kombinohet në çdo rast me analizën e proporcionalitetit të kufizimit. Kufizim i cili në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë kufizimet që parashikon Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut siç është interpretuar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane.

Në lidhje me procesin e rregullt, neni A i Aneksit të Kushtetutës parashikon kufizimin e së drejtës për të paraqitur ankim kushtetues individual përpara Gjykatës Kushtetuese (neni 131/f) Jemi të mendimit, se kufizimi për të

³² po aty, fq. 475.

paraqitur ankim kushtetues, në thelb është përjashtim nga kjo e drejtë, që në përmbajtje do me thënë një privim i kësaj të drejte gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Ky proces rivlerësimi, presumohet si në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Tjetër kufizim i procesit të rregullt ka të bëjë me barrën e kalimit të. Ky kufizim edhe pse nuk parashikohet shprehimisht nga neni A i Aneksit të Kushtetutës përbën një veçori të sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Meqenëse ky kalim i barrës së provës ka natyrë kufizuese, jemi të mendimit se duhet të interpretohet në mënyrë korrekte, baza faktike dhe juridike që përligj kalimin e barrës së provës, duke zbatuar në mënyrë rigoroze rastet faktike kur parashikohet si kusht kalimi i barrës së provës dhe baza juridike mbi të cilën mbështet ky kufizim. Pra, që të zbatohet drejt kjo dispozitë, është tepër e rëndësishme të përcaktohet drejt baza, objekti dhe fusha e veprimit të kësaj dispozite, shkaqet dhe faktet mbi të cilat mbështeten gjetjet. Nga ana e organeve të rivlerësimit nuk është evidentuar një praktikë e qartë në lidhje me interpretimin sistematik të këtij kufizimi;

Kufizim tjetër janë edhe kufizimi i zhvillimit të proceseve disiplinore të zakonshme për gjyqtarët dhe prokurorët. Në opinionin e Komisionit të Venecias lidhur me ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve parashikohet se Komisioni i Venecias thekson që procedimi disiplinor kundër gjyqtarëve bazuar në ligj duhet t'i korrespondojë disa parimeve bazë, që përfshijnë si vijon: përgjegjësia duhet të vijë pas shkeljes së detyrës të përcaktuar shprehimisht në ligj; palët dhe përfaqësuesi i gjyqtarit duhet të dëgjohen në mënyrë të drejtë dhe të plotë; ligji duhet të përcaktojë masën e sanksionit; dhënia e masës duhet të bëhet sipas parimit

të proporcionalitetit; duhet të parashikohet e drejta për t'u ankimuar përpara një autoriteti më të lartë gjyqësor.³³

Veçori e procesit të rivlerësimit parashikuar nga Neni “Ç” pika “4”, fjalja e fundit të Aneksit të Kushtetutës; pika “5” e Nenit “Ç” të Aneksit të Kushtetutës, neni “Dh” pika “3” dhe pika “4” e Aneksit të Kushtetutës, neni “E” pika “3” dhe pika “4” e Aneksit të Kushtetutës, janë dispozitat të cilat parashikojnë ngarkimin e subjektit me ‘barrën e provës’ për të provuar të kundërtën e saj çka është konstatuar nga hetimi paraprak i organeve të rivlerësimit. Gjithashtu, edhe pjesëmarrja e publikut në procesin e rivlerësimit mbi fakte ose rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit është e një rëndësie të veçantë që buron nga qëllimi dhe misioni i këtij procesi të jashtëzakonshëm dhe kalimtar, i cili pritet të rikthejë besimin e shtetasve në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Sipas Nenit 6 të KEDNJ-së, e drejta për proces të rregullt zbatohet në procedurat për përcaktimin e të drejtave civile dhe “detyrimet” e personave. Në rastin konkret gjendemi vetëm për përcaktimin e një detyrimi disiplinor. GJEDNJ ka vërejtur se do të ekzistojë një prezumim se neni 6 i Konventës është i zbatueshëm, dhe se do të jetë për qeverinë e paditur të provojë 1) që një ankues si nëpunës civil nuk ka të drejtë të aksesit në gjykatë sipas ligjit kombëtar dhe 2) që përjashtimi i të drejtave sipas nenit 6 për nëpunësin civil është i arsyeshëm. Pra, nëse ankuesi, duke qenë një nëpunës civil ose gjyqtar, ka qasje në një gjykatë sipas ligjit kombëtar, neni 6 i Konventës është i zbatueshëm. Ky përfundim është i njohur edhe si testi Eskelinen.

Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duke zbatuar testin Eskelinen, kur ka interpretuar të drejtën e mbrojtjes, më konkretisht, të

³³ Venice Commission, ‘Opinion on the Law on Disciplinary Responsibility and Disciplinary Prosecution of Judges of Common Courts of Georgia’ (adopted by the Venice Commission at its 70th Plenary Session, 16-17 March 2007) CDL-AD(2007)009, para 9.

drejtën e individit për t'u njohur me provat e përdorura, ka theksuar se këto të drejta shtrihen dhe gjejnë zbatim edhe në rastin e procedurave të ngjashme disiplinore³⁴ si edhe në rastin e procedimeve disiplinore kundër gjyqtarëve.³⁵ Në rastin *Harabin kundër Sllovakisë*, GjEDNj-ja ka theksuar rëndësinë që ka zbatimi i nenit 6 të Konventës veçanërisht në procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve. Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane është përcaktuar, se gjen zbatim dhe duhet të respektohet neni 6 i Konventës në "pjesën civile" të saj, e cila është e zbatueshme në këto procedura.³⁶ Më pas, në *rastin Olujić kundër Kroacisë*, Gjykata Evropiane vendosi se fusha e mbrojtjes e nenit 6 përfshin rastet e shkarkimit të një gjyqtari, përveç nëse sistemi i brendshëm përjashton qasjen në gjykatë në atë rast.³⁷

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 10 të saj parashikon se: gjithkush ka të drejtë në barazi të plotë për një seancë dëgjimore të drejtë dhe publike nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij dhe të çdo akuze penale kundër tij. Kombet e Bashkuara në kuadër të kësaj ka parashikuar standarde të përgjithshme që përshkruajnë këtë parim, në veçanti Parimet Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1985 dhe Parimet e Bangalore të Sjelljes Gjyqësore në vitin 2002.

Edhe Këshilli i Evropës gjithashtu ka zhvilluar më tej këto standarde. Instrumentet më të rëndësishëm në këtë drejtim janë Rekomandimi (94) 12 i

³⁴ ECHR, *Le Compte, Van Leuven and de Meyere v. Belgium*, Application no. 6878/75 and 7238/75; ECHR, *Philis v. Greece*, Application No. 28970/95, para 45; ECHR, *Marušić v. Croatia*, Application no. 79821/12, paras 72-73; ECHR, *Vilho Eskelinen and Others v. Finland*, Application no. 63235/00.

³⁵ ECHR, *Kamenos v. Cyprus*, application no. 147/07, para 73; ECHR, *Oleksander Volkov v. Ukraine*, Application no. 21722/11.

³⁶ ECHR, *Vilho Eskelinen and Others v. Finland*, Application no. 63235/00, ECHR, *Baka v. Hungary*, Application no. 20261/12.

³⁷ ECHR, *Olujić v. Croatia*, Application no. 22330/05.

Komitetit të Ministrave për Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve,³⁸ i zëvendësuar nga Rekomandimi (2010) 12 E i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për Gjyqtarët: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë.³⁹ Këshilli gjithashtu ka miratuar Kartën Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, 1998. Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve datë 8 -10 korrik 1998, ka parashikuar se:

1.3.Në lidhje me çdo vendim që ndikon në zgjedhjen, rekrutimin, emërimin, përparimin në karrierë ose përfundimin e detyrës së një gjyqtari, statuti parashikon ndërhyrjen e një autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ brenda të cilit të paktën gjysma e atyre që bëjnë pjesë janë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, duke ndjekur metodat që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit .

5.1.Mos respektimi nga një gjyqtar i një prej detyrave të përcaktuara shprehimisht nga statuti, mund t'i japë shkasë zbatimit të një sanksioni në bazë të vendimit, propozimit, rekomandimit, ose me marrëveshjen e një gjykate ose autoriteti të përbërë të paktën gjysma, gjyqtarë të zgjedhur, sipas procedurave të një karakteri që përfshin dëgjimin e plotë të palëve, në të cilën gjyqtari i proceduar, duhet të ketë të drejtë përfaqësimi. Shkalla e sanksioneve që mund të vendosen përcaktohet në statut dhe vendosja e tyre i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit. Vendimi i një autoriteti ekzekutiv, i një gjykate, ose i një autoriteti që vendos një sanksion, siç parashikohet këtu, duhet të jetë i hapur për ankim pranë një autoriteti më të lartë gjyqësor [...]

7.1. Një gjyqtar pushon përfundimisht të ushtrojë detyrën përmes dorëheqjes, certifikatës mjekësore për mungesë së aftësisë fizike, arritjes së kufirit të moshës për pension, skadimit të një afati ligjor të fiksuar për mandatin, ose shkarkimit të dhënë sipas një procedure të parashikuar në paragrafin 5.1 të këtij neni.

³⁸ Recommendation No R(94) 12 on the independence, efficiency and role of judges.

³⁹ Rekomandimi CM/Rec(2010)12 për pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë.

7.2. Ndodhja e njërit prej shkaqeve të parashikuara në paragrafin 7.1 të këtij neni, përveç arritjes së kufirit të moshës për pension ose skadimit të një mandati të caktuar, duhet të verifikohet nga autoriteti i përmendur në paragrafin 1.3 të këtij (European Charter on the Statute for Judges, 1998).

Rekomandimi CM/ Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare mbi gjyqtarët: pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë, miratuar më 17 nëntor 2010, parashikon se:

49. Siguria e mandatit dhe patundshmëria janë elementet kryesore të pavarësisë së gjyqtarëve. Prandaj, gjyqtarët duhet të kishin të garantuar mandatin deri në moshën e pensionit të detyrueshëm, kur ekziston një e tillë.

50. Kushtet e detyrës së gjyqtarëve duhet të përcaktohen me ligj. Një emërim i përhershëm duhet të përfundojë vetëm në rastet e shkeljeve të rënda të dispozitave disiplinore ose penale të përcaktuara me ligj, ose kur gjyqtari nuk mund të kryejë më funksione gjyqësore. Pensionimi i parakohshëm duhet të jetë i mundur vetëm me kërkesë të gjyqtarit në fjalë ose për arsye mjekësore.

52. Një gjyqtar nuk duhet të marrë një emërim të ri ose të zhvendoset në një zyrë tjetër gjyqësore pa miratimin e tij, përveç në rastet e sanksioneve disiplinore ose reformës së organizimit së sistemit gjyqësor.

Norma të hollësishme janë miratuar nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), si një organ brenda Këshillit të Evropës: Opinioni Nr. 1 mbi Standardet në lidhje me Pavarësinë e Gjyqësorit dhe Papërkulshmërinë e Gjyqtarëve;⁴⁰ Opinioni nr. 2 mbi financimin dhe menaxhimin e

⁴⁰ Opinion No 1 (2001) on Standards Concerning the Independence of the Judiciary and the Irremovability of Judges

gjykatave;⁴¹ Opinioni nr. 6 mbi gjykimin e drejtë brenda një kohe të arsyeshme;⁴² Opinioni nr. 10 mbi Këshillin e Gjyqësorit në Shërbimin e Shoqërisë;⁴³ dhe Opinioni nr. 11 mbi cilësinë e vendimit gjyqësor.⁴⁴ CCJE ka deklaruar në Magna Carta të Gjyqtarëve Evropianë se të njëjtat parime zbatohen *mutatis mutandis* për të gjithë gjyqtarët nga gjykatat evropiane dhe ndërkombëtare.

Opinioni nr. 1 (2001) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) mbi standardet në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe patundshmërinë e gjyqtarëve, miratuar më 23 nëntor 2001, parashikon se është një parim themelor i pavarësisë gjyqësore që mandati të garantohet deri në moshën e pensionit të detyrueshëm ose skadimit të një mandati të caktuar (paragrafi 12). Karta Evropiane [mbi Statutin për Gjyqtarët] parashikon se ky parim shtrihet në emërimin ose caktimin në një detyrë ose në një seli me vendndodhje tjetër pa pëlqim (përveç në rastin e riorganizimit të gjykatës ose përkohësisht), por edhe ai dhe Rekomandimi Nr 94) 12 parashikon se transferimi në detyra të tjera mund të urdhërohet me anë të sanksionit disiplinor.

Rekomandimi Nr. R (94) 12, Parimi VI (2) dhe (3), thekson në nevojën për përcaktimin e saktë të shkeljeve disiplinore për të cilat një gjyqtar mund të shkarkohet nga detyra dhe për procedurat disiplinore në përputhje me kërkesat e procesit të rregullt të Konventës mbi të Drejtat e Njeriut.⁴⁵ Përpos kësaj citohet se vetëm shtetet duhet të marrin në konsideratë ngritjen, me ligj, të një organi të veçantë kompetent i cili ka si detyrë të zbatojë çdo sanksion

⁴¹ Opinion No 2 (2001) on the Funding and Management of Courts with reference to the Efficiency of the Judiciary and to Article 6 of the European Convention on Human Rights.

⁴² Opinion No 6 (2004) on Fair Trial within a Reasonable Time and judge's role in trials taking into account alternative means of dispute settlement.

⁴³ Opinion no.10(2007) on the Council for the Judiciary at the service of society.

⁴⁴ Opinion no.11(2008) on the quality of judicial decisions'.

⁴⁵ Recommendation No R (94) 12 on the independence, efficiency and role of judges.

disiplinor dhe masa të tjera, kur ato nuk trajtohen nga një gjykatë, vendimet e këtij organi do të kontrollohen nga një organ gjyqësor superior, ose i cili është vetë një organ gjyqësor superior.

Magna Carta e Gjyqtarëve (Parimet Themelore) miratuar nga CCJE në nëntor 2010, parashikon se:

1. Gjyqësori është një nga tre pushtetet e çdo shteti demokratik. Misioni i tij është të garantojë vetë ekzistencën e sundimit të ligjit dhe, në këtë mënyrë, të sigurojë zbatimin e duhur të ligjit në një mënyrë të paanshme, të drejtë, të drejtë dhe efikase.
2. Pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit janë parakushte thelbësore për funksionimin e drejtësisë.
3. Pavarësia gjyqësore do të jetë statutore, funksionale dhe financiare. Ai do të garantohet në lidhje me kompetencat e tjera të Shtetit, për prokurorët, gjyqtarë të tjerë dhe shoqërinë në përgjithësi, me anë të rregullave kombëtare në nivelin më të lartë. Shteti dhe secili gjyqtar janë përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore.
4. Pavarësia e gjyqësorit do të garantohet në lidhje me veprimtaritë gjyqësore dhe veçanërisht në lidhje me rekrutimin, emërimin deri në moshën e pensionit, ngritjet në detyrë, pandërprerjen, trajnimin, imunitetin gjyqësor, disiplinën, shpërblimin dhe financimin e gjyqësorit.
6. Procedurat disiplinore do të zhvillohen para një organi të pavarur me mundësinë e ankimit para gjykatës.

Nga analiza e këtyre dispozitave dhe akteve, rezulton se gjithnjë e më tepër, parimet e procesit të rregullt po zbatohen edhe në proceset me natyrë disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, mënyra dhe shkalla e zbatimit të procesit të rregullt ndryshon nga lloji i procesit dhe nga garancitë e njohura shprehimisht. Nga analiza e dispozitave kushtetuese rezulton shprehimisht e parashikuar nga dispozitat në fjalë zbatimi i procesit të rregullt, përbërja e të cilit në disa parime parashikohet nga vetë Kushtetuta,

dhe për disa parime të tjera zbërthehen në ligjin e posaçëm për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

3. Kushtetutshmëria e ligjit nr.84/2016 për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nën dritën e vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese

Ligji nr.84/2016 për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve i është nënshtruar shqyrtimit për kushtetutshmëri përpara Gjykatës Kushtetuese me kërkesë të një grupi të caktuar deputetesh të opozitës së djathtë. Gjykata Kushtetuese e ka shqyrtuar ligjin nr.84/2016 për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në raport me disa pretendime të ndryshme për kushtetutshmërinë e tij në raport me përcaktimet kushtetuese në fuqi në çastin e miratimit të tij.

Në lidhje me aspektet e procesit të rregullt ligjor, sa i përket elementit të pavarësisë së organeve ndihmëse që do të ndihmojnë procesin e rivlerësimit dhe raportin e tyre me parimin e pavarësisë së organeve të rivlerësimit me organet ndihmëse, Gjykata Kushtetuese në vendimin 2/2017, ka vërejtur se pavarësia ligjore e institucioneve që mbikëqyrin procesin e mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave në kuadër të sistemit të deklarimit të pasurive, mund të garantohet me anë të mjeteve të ndryshme ligjore dhe se përzgjedhja e kreut të ILDKPKI-së nëpërmjet një procesi të hapur publik dhe transparent, përbën një mjet ligjor që garanton.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, është vetë Kushtetuta që i ka njohur ILDKPKI-së kompetencën për realizimin e procedurës së kontrollit të deklaratës dhe përgatitjen e raportit të hollësishëm në lidhje me ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklarimit. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë kushtetutëbërësi ka përcaktuar qartësisht organin që do të kryejë procedurën e kontrollit të deklaratës dhe kompetencat e këtij organi, të cilat janë detajuar

më tej në ligjin nr.84/2016. Edhe pse ligji ka parashikuar në mënyrë më të detajuar kompetencat e ILDKPKI-së dhe rolin e saj konkret në këtë proces, nuk rezulton që ato të bien ndesh me kompetencën kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe as e cenon në thelb atë.

Ndërsa sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike dhe raportit të organeve vlerësuese me pavarësinë e organeve të rivlerësimit, sipas nenit 10/3 të ligjit organet e vlerësimit të aftësive profesionale për gjyqtarët është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për prokurorët është struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme ose institucionet që bëjnë vlerësimin profesional sipas ligjit, ndërsa për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë është pjesërisht Shkolla e Magjistraturës për testimin, si dhe një strukturat përkatëse të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, apo të Prokurorisë së Përgjithshme.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, këto organe ndihmëse nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ligjore në mënyrë të shkëputur nga veprimtaria e organeve të rivlerësimit, KPK-ja dhe KA-ja, por nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtyre të fundit (para 32).

Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese, ka arritur në përfundimin se të gjitha kompetencat që i ka njohur ligji këtij organi janë në përputhje me parashikimet e neneve E dhe Ë të Kushtetutës dhe nuk prekin apo bien ndesh me kompetencat e organeve të rivlerësimit në këtë proces. Edhe në lidhje me procesin e kontrollit të figurës në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në kuadër të një interpretimi pajtues të ligjit me normën kushtetuese, ajo çfarë ka rëndësi në këtë gjykim është thelbi i kompetencave që ligji u ka njohur organeve të tjera të përfshira në proces, pra ato që lidhen me realizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave dhe të vlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit (para 36). Pika “4” e nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës i jep

organeve të rivlerësimit kompetenca të gjera për të shqyrtuar dhe hetuar vetë çështjet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Organet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses tek të gjitha materialet përkatëse.

Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se përdorimi i një grupi pune sipas nenit 36 të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk shfaq probleme kushtetutshmërie nëse ai nuk përbëhet vetëm nga personeli i organeve të sigurisë, por përfshin edhe përfaqësues të KPK-së (para 39).

Përfundimi i Gjykatës Kushtetuese është se autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme, dhe pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Qëllimi dispozitave të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriteret dhe mënyra e realizimit të këtij procesi. Në këtë kuptim, e gjithë fryma që përshkon dispozitat kushtetuese dhe që reflektohet edhe në dispozitat konkrete të ligjit të kundërshtuar është se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore ekzistuese.

Sa i takon elementit të pavarësisë së organeve të rivlerësimit, në raport me pushtetet e tjera, veçanërisht ekzekutivin dhe ligjvënësin, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se, Kushtetuta ia ka përcaktuar kompetencën

kushtetuese KA-së, duke e konceptuar atë si organ gjyqësor për ankimimin e vendimit të KPK-së, dhe që vepron sipas rregullave që zbatohen edhe nga Gjykata Administrative e Apelit (para 59). Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (para 67).

Në lidhje me procesin e rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se, në kuadër të procesit të rivlerësimit, shkarkimi i gjyqtarit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, kryhet pas një procesi të vlerësimit të shkaqeve dhe provave të administruara nga organet disiplinore apo ato të rivlerësimit sipas rastit dhe pas një procesi të bazuar në prova dhe duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (para 66).

Parashikimet e bëra në Kushtetutë dhe në ligjin për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas Gjykatës Kushtetuese i garantojnë subjekteve të rivlerësimit të drejtën e ankimit në një shkallë më të lartë gjykimi, sipas nenit 43 të Kushtetutës, e cila ka të drejtë të gjykojë në themel çështjen dhe të vendosë përfundimisht në lidhje me të. Ndërsa në

lidhje me kufizimin e të drejtës kushtetuese për ankim kushtetues individual me Kushtetutën, çka që lidhet me të drejtën e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sipas kësaj gjykate, nëse ky kufizim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi për sa kohë që ai jo vetëm është vendosur në rang kushtetues, por edhe sepse Gjykata nuk ka juridiksion për vlerësimin në themel të këtyre dispozitave, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutë me anë të një ligji rishikues. Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën.

Sa i përket pretendimit se dispozitat e ligjit nr.84/2016 nuk kanë detajuar asnjë rregull procedural për të garantuar elementet bazë të procesit të rregullt dhe respektimin e të drejtave themelore të subjekteve të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter disiplinor administrativ (para 73). Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt si një e drejtë themelore. Kjo e drejtë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur. Palët pjesëmarrëse në një procedim administrativ janë autoriteti kompetent, nga njëra anë, dhe pala e interesuar, nga ana tjetër. Në këtë gjykim secila nga palët ka detyrimet e veta procedurale. Sipas nenit 47 të ligjit, të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit

rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35 - 40 dhe neneve 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Po ashtu, ligji ka parashikuar detyrimin për njoftimin e subjektit të rivlerësimit (neni 46), të drejtën e subjektit për t'u dëgjuar në seance dëgjimore (neni 55), detyrimin e institucionit të rivlerësimit për të arsyetuar vendimin (neni 57), të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u ankuar ndaj vendimit të KPK-së (neni 63), si edhe ka përcaktuar rregullat e gjykimit në Kolegjin e Apelimit në përputhje me rregullat e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative (neni 65) etj. Edhe pse ligji nuk ka parashikuar afate specifike për shqyrtimin e çështjeve apo vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit, kjo nuk nënkupton *a priori* se procesi do të shkaktojë vonesa të paarsyeshme. Për shkak të natyrës specifike të këtij procesi, kushtetutëbërësi ka vlerësuar të mjaftueshme të parashikojë se në ushtrimin e kompetencave të tyre organet e rivlerësimit u nënshtrohen jo vetëm rregullave të procesit të rregullt, një element i së cilit është edhe shqyrtimi i çështjeve brenda afateve të arsyeshme, por bazohen edhe në dispozita të tjera procedurale, për aq sa janë të zbatueshme.

4. Parimi i procesit të rregullt ligjor sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësim kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Ligji organik nr. 84/2016 për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH rregullon mënyrën e krijimit dhe të funksionimit të organeve të rivlerësimit, rolin dhe kompetencat e tyre, gjithashtu, rolin dhe kompetencat e organeve ndihmëse dhe vëzhguesve të ONM-së në këtë proces, parimet e procesit, mënyrën se si zhvillohet hetimi administrativ i të tre kriterëve dhe seanca dëgjimore me subjektet, bashkëpunimi me publikun, ushtrimi i të drejtës së ankimit, etj. Proces i rivlerësimit i gjyqtarëve dhe

prokurorëve ka në themelet e tij kontrollin e posaçëm mbi bazën e tre kritereve: pasurinë, figurën, dhe aftësitë profesionale.

Ligji i posaçëm nr. 84/2016, për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve që zbërthen parimet kushtuese të procedurës së rivlerësimit parashikon në mënyrë të shprehur detyrimin e institucioneve të rivlerësimit që të respektojnë parimet e procesit të rregullt ligjor. Këto organe janë sipas Kushtetutës të pavarura dhe të paanshme. Për procesin e rivlerësimit janë ngritur institucione kushtuese, të pavarura dhe të specializuara, të cilat i kanë të lidhura kompetencat e tyre vetëm me këtë proces.

Paanshmëri do të thotë mungesë të çfarëdolloj paragjykimi, ose të çfarëdolloj interesi material apo personal të personit vendimmarrës në çështjen që ai ka për shqyrtim. Duke u mbështetur vetëm në ligjin dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, duke mos u ndikuar nga presionet e jashtme dhe ndikimet e padrejta. Secili vendimmarrës, duke përfshirë edhe anëtarët e trupës gjyquese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbartin detyrimin për të mbajtur dhe ndjekur një sjellje që do të pasqyrojë edhe dukjen e paanshmërisë, pra ata duhet, jo vetëm të jenë, por edhe të duken si të paanshëm. Në zbatim dhe interpretim të nenit 6/1 të Konventës Evropiane, Gjykata Evropiane ka përpunuar disa kritere dhe parime lidhur me zbatimin e parimi të paanshmërisë në procedurat vendimmarrëse. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e kriterit subjektiv dhe atë objektiv.

Kriteri subjektiv është përpunuar në lidhje me identifikimin e atyre formave të ushtrimit të funksionit që nuk janë në përputhje me ushtrimin e rregullt e të drejtë të detyrës. Kriteri subjektiv bazohet në faktin se asnjë anëtar i trupës vendimmarrëse nuk duhet të ketë asnjë paragjykim, apo paracaktim pa përfunduar rregullisht procedura.

Kriteri objektiv nënkupton faktin se personi që merr pjesë në vendimmarrje, jo vetëm nga pikëpamja mendore duhet të jetë i paanshëm, në kuptimin se nuk duhet të ketë ose shfaqet me paragjykime mendore apo përkrahje personale, por edhe se objektivisht duhet të japë siguri të besueshme që zhdukin çdo dyshim njëanshmërie.

Nenit 45 i këtij ligji parashikon detyrimin e trupës gjyquese të hetojë dhe vlerësojë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Procedura e rivlerësimit mbikëqyret nga një përfaqësues ndërkombëtar i ONM-së, i cili merr pjesë në të gjithë dhomat e këshillimit që zhvillon trupa gjyquese që nga çasti i fillimit të hetimit kryesisht të kësaj procedure rivlerësimi.

Në procesin e rivlerësimit, roli i anëtarit-relator është shumë i rëndësishëm të parashikuar nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në bazë të nenit 14, pika “5” të ligjit nr. 84/2016, parashikohet shprehimisht se: “Relatori i çështjes ka këto detyra: (a) të përgatisë dosjen që diskutohet nga trupi gjyques; (b) të ndërmarrë të gjitha procedurat për të garantuar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjyquese; (c) të marrë të gjitha masat për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm, deri në përfundimin e çështjes; (ç) të kërkojë informacion shtesë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; (d) të propozojë marrjen e një vendimi duke parashtruar arsyetimin. Këto detyra janë tepër të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e procedurës së rivlerësimit.

Gjithashtu, për procesin e rivlerësimit të gjyqtareve dhe prokurorëve, është miratuar edhe Rregullorja për miratimin e Hapave Proceduralë të Unifikuar, me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 7, datë 14.02.2018. Qëllimi i miratimit të hapave proceduralë të unifikuar është zbatimi i parimit të transparencës, i parimit të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 55 të ligjit

nr. 84/2016, Komisioni fton subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Qëllimi i seancës dëgjimore është mbrojtja dhe krijimi i një debati, nëpërmjet shpjegimeve, komenteve dhe paraqitjes së prova të tjera mbi provat dhe gjetjet gjatë gjithë fazës së hetimit nga ana e trupës shpjeguese. E drejta për të dëgjuar subjektin e rivlerësimit në kuadër të parimit të barazisë së armëve do të thotë se argumentet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat që i konfirmojnë ato mund të ndikojnë në arritjen e një vendimmarrje të drejtë e të arsyeshme, si edhe rrit shkallën e zbatimit të ligjit dhe efektivitetit të vendimmarrjes dhe pranimin e rezultatit që rrjedh prej kësaj.

Vendimi i organeve të rivlerësimit duhet të arsyetohet. Respektimi i këtij parimi detyrues me natyrë kushtetuese dhe si e drejtë themelore e subjektit të rivlerësimit ka një rëndësi të madhe, pasi ligjshmëria e vendimit mund të vlerësohet dhe të kontrollohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Në bazë të nenit “Ë” pika “1” parashikohet se “Komisioni ose Kolegji i Apelimit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Në çdo rast vendimi jepet i arsyetuar”.

Në nenin 4/2 të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet shprehimisht se: “Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”.

5. Aspekte të zbatimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor në procesin e rivlerësimit vështrim i Gjykatës Evropiane

Për shumë aspekte, procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, është tepër i veçantë dhe me karakter kalimtar dhe të jashtëzakonshëm. Me këto karakteristika është e vështirë të bëhet një vlerësim i zbatimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor në procedurën rivlerësuese, pasi mungon një standard krahasimi dhe një kriter unik që mund të matë shkallën e efektivitetit dhe zbatueshmërisë për situata kalimtare dhe të jashtëzakonshme.

Procedura e rivlerësimit, mund të konsiderohet si një lloj i veçantë procedure, në të cilën hetimi i çështjes së rivlerësimit për një kriter ose tre kriteret bëhet kryesisht nga ana e një trupe gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Hetimi fillon mbi bazën e të dhënave dhe formularëve të plotësuar nga subjektet e rivlerësimit, dhe rezultatet e gjetjeve ngarkojnë me barrën e provës për të provuar të kundërtën subjektet e rivlerësimit. Subjekti që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit ka të drejtën për t'u njohur me rezultatet e gjetjeve dhe për të paraqitur prova në favor të mbrojtjes së tij, si dhe të drejtën të kërkojë marrjen e provave nga trupa gjykuese, e cila duhet të disponojë me vendim të arsyetuar. Pas kësaj, themeli i gjetjeve shqyrtohet në një seancë publike dëgjimore, në të cilën merr pjesë e njëjta trupë që ka kryer hetimin kryesisht, subjekti i rivlerësimit dhe vëzhguesi ndërkombëtar.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të mbrohet, me anë të një përfaqësuesi, duke paraqitur prova, shpjegime mbi gjetjet e trupës gjykuese. Në përfundim të shqyrtimit, trupa gjykuese merr një vendim lidhur mbi shkarkimin ose konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Vendimi i trupës gjykuese jepet me shkrim dhe i arsyetuar. Ai i njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerit publik, dhe vëzhguesit ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit dhe komisioneri publik ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda

15 ditëve nga njoftimi i tij. Operacioni i Monitorimit Ndërkombëtar mund të paraqesë një opinion të nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtare pranë komisionerit publik për ankimimin e vendimit të trupës gjyquese. Ky opinion nuk është i detyrueshëm për komisionerin publik, por nëse nuk ndiqet detyron komisionerin të arsyetojë mos ndjekjen e tij. Mund të thuhet se procedurat e rivlerësimit ndjekin një procedure civile të lloji inkuizitor, ku ka një rol aktiv të trupës e cila bën gjetjet dhe i diskuton ato me subjektin e rivlerësimit. Aspekte të pa diskutuara mbeten vendimmarrjet e ndërmjetme mbi pranimin e kërkesës për marrjen e provave nga ana e organeve të rivlerësimit, deri më tani nuk ka pasur ndonjë vendimmarrje dhe një qëndrim të konsoliduar në lidhje me këtë aspekt të rëndësishëm të procesit të rivlerësimit. Edhe jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka përcaktuar disa elementë të rëndësishme të procesit të rregull, si e drejta për t'u dëgjuar, apo për mosshqyrtimin e kërkesës së për përjashtimin nga gjykimi i mëtejshëm anëtarit të trupit gjyques, duke përcaktuar se shqyrtimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin nga gjykimi i mëtejshëm i komisioneres nga i njëjti trup gjyques i Komisionit, përpara të cilit u paraqit kërkesa, përbën shkelje të rëndë procedurale⁴⁶. KPA ka përcaktuar se vërtetohet se subjektit të rivlerësimit, në Komision i është garantuar e drejta e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një organ i pavarur dhe i paanshëm. Sipas akteve të administruara në proces, Komisioni i ka dhënë më parë të drejtën për të paraqitur mendime, shpjegime dhe prova për faktet, rrethanat apo çështjet

⁴⁶ Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Vendimi nr. 1, datë 31.01.2019 <<http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.-1-date-31.01.2019-subjekti-Artan-Lazaj-vendimi-mendimi-i-pakic%C3%ABs-per-publikim.pdf>> aksesuar më 1 Nëntor 2022.

ligjore, të depozitohet prova, si dhe vendimi i është komunikuar publikisht⁴⁷. Sa u përket procesverbaleve të mbajtura në dhomë këshillimi, ato sipas KPA janë akte të brendshme dhe të hartuara në Komision, të cilat reflektojnë vendimmarrjen për të cilën subjekti është vënë në dijeni. Gjithsesi, mosnjohja e subjektit me to nuk është shkak për proces të parregullt ligjor. Sa i përket analizës statistikore, janë dhënë mbi 230 vendime nga ana e organeve të rivlerësimit. Nga të cilat, rezultojnë 109 shkarkime, 111 konfirmime në detyrë dhe 46 dorëheqje.

Këndvështrimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të konsiderohet si një vlerësim i paanshëm dhe objektiv i masave të ndërmarra nga Shqipëria dhe e mënyrës së zbatimit të procesit të rivlerësimit dhe duhet të paraqitur si një qëndrim që një organ i drejtësisë ndërkombëtare ka për procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Në rastin e parë, që Gjykata Evropiane është shprehur, Xhoxhaj k. Shqipërisë⁴⁸, në lidhje me pretendimet për mosrespektimin e parimeve të procesit të rregullt. I cili nuk është ende përfundimtar, Gjykata Evropiane ka vërejtur se parimet e procesit të rregullt për fushën civile janë të zbatueshme në procedurat e ndjekura për procesin e rivlerësimit. Ndërsa parimet minimale të procesit të rregullt në fushën penale, në vlerësimin e gjykatës nuk janë të zbatueshme në procedurat e rivlerësimit. Në vlerësimin e gjykatë, shkeljet e konstatuara përbëjnë shkelje të llojit disiplinor dhe jo vepra penale. Shkarkimi i ankueses, përbën një sanksion tipik disiplinor dhe jo një sanksion penal.

⁴⁷ Kolegji i Posaçëm i Apelit, Vendimi nr. 2, datë 04.02.2019 <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.-2-date-04.02.2019-subjekti-i-rivleresimit-Artan-Zeneli_web-i-fundit.pdf> aksesuar më 1 Nëntor 2022.

⁴⁸ ECHR, *Xhoxhaj v. Albania*, Application no. 5227/19.

Pretendimet mbi mungesën e përbërjes së organeve të rivlerësimit me të paktën gjysmën me përfaqësues të pushtetit gjyqësor dhe parimit të gjykatës së krijuar me ligj për këto organe, Gjykata Evropiane nuk i vlerësoi si të bazuara. Sipas Gjykatës Evropiane, duke pasur parasysh faktin që organet e rivlerësimit: KPK dhe KPA ishin ngritur dhe përbërë në një mënyrë legjitime, përmbush kërkesat e një "gjykate të themeluar nga ligji", ankuesi kishte qasje në një "gjykatë", në kuptim të paragrafit të parë dhe sipas testit të rastit Vilho Eskelinen. Edhe pretendimet mbi pavarësinë e organeve të rivlerësimit, Gjykata Evropiane nuk sheh prova të mungesës të pavarësisë nga ana e organeve të rivlerësimit. Lidhur me paanshmërinë e organeve të rivlerësimit, sipas Gjykatës nuk ka asnjë konfuzion midis statusit të KPK dhe detyrimit për të hapur hetimin, në të cilin nuk ka akuza ose gjetje për shkelje. Një parashikim i tillë procedural është jo i rrallë në procedurat disiplinore ose procedurat e tjera administrative në sistemet juridike evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, thjesht fakti që KPK ka bërë gjetjet paraprake në çështjen e ankueses nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar objektivisht frikën për paanësinë e KPK. Edhe për KPA, Gjykata nuk sheh prova të mungesës të pavarësisë dhe paanësisë së këtij organi rivlerësimi.

Gjykata nuk e gjeti të bazuar pretendimin e ankueses për mungesë të pavarësisë së KPK-së dhe Kolegjit të Apelimit. Ajo nuk pati dyshime për mënyrën e zgjedhjes të anëtarëve të organeve të rivlerësimit, pasi zgjedhja e tyre kishte qenë në përputhje me procedurën ligjore. Dokumentet në dosje treguan se, pas emërimit të tyre, ato nuk i ishin nënshtruar ndonjë presioni nga pushteti ekzekutiv gjatë shqyrtimit të rastit të kërkuës.

Përsa i përket paanshmërisë, Gjykata vuri re se nuk kishte dyzim të roleve të KPK-së: detyrimi ligjor për të filluar hetimin ishte automatik dhe nuk kushtëzohej nga ngritja e ndonjë «akuze» për shkelje disiplinore ndaj

kërkueses; gjetjet paraprake të tij ishin bazuar mbi informacionin që ndodhej në dosje kur ende nuk ishin marrë parasysh argumentet mbrojtëse të kërkueses; dhe ai e kishte marrë vendimin mbi përgjegjësinë disiplinore të kërkueses mbi bazën e të gjitha parashtrimeve që ishin bërë, duke përfshirë provat që kishte paraqitur dhe argumentet që ajo kishte ngritur në seancë publike. Sipas Gjykatës, fakti që KPK-ja kishte bërë gjetjet paraprake në rastin e kërkueses nuk përbënte dyshim të justifikuar në mënyrë objektive për anshmërinë e tij. Përsa i përket Kolegjit të Apelimit, Gjykata çmoi se kërkuesja nuk kishte paraqitur ndonjë argument thelbësor. Gjykata vlerësoi që Kolegji i Apelimit kishte patur juridiksion të plotë për shqyrtimin e shkaqeve të ankimit të kërkueses dhe kishte dhënë një vendim të detajuar në rastin e saj.

Në lidhje me drejtshmërinë dhe rregullsinë e procedurave të rivlerësimit, Gjykata Evropiane ka vërejtur se e drejta për një seancë të drejtë të garantuar nga neni 6/1 i Konventës përfshin të drejtën e palëve në procedurat gjyqësore për të paraqitur çdo vërejtje që ata e konsiderojnë të rëndësishme për çështjen e tyre. Kjo e drejtë mund të shihet të jetë efektive vetëm nëse vëzhgimet janë "dëgjuar", domethënë, merren në shqyrtim siç duhet nga gjykatat vendase. Me fjalë të tjera, efekti i Nenit 6 është, ndër të tjera, të vendosë "gjykatën" nën një detyrimin që të kryejë një ekzaminim të duhur të parashtrimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e tij nëse ato janë të rëndësishme. Gjykata nuk i vlerësoi vendimmarrjet e organeve të rivlerësimit (KPK dhe KPA) në rastin e ankueses të paarsyeshme dhe të padrejta.

Sa i përket pretendimit për mos zhvillimin e një seance 'publike' nga KPA, Gjykata Europiane ka vërejtur se, detyrimi për të mbajtur një seancë dëgjimore publike nuk është absolut, në kontekstin e procedurave disiplinore

ndaj gjyqtarëve, në funksion të asaj që ka rëndësi, përkatësisht ndikimit të dënimeve të mundshme në jetën dhe karrierën e personave në fjalë dhe implikimet e tyre financiare, moszhvillimi i një seance dëgjimore duhet të përbëjë një masë e jashtëzakonshme dhe duhet të justifikohet në përshtatje me rastin në dritën e praktikës gjyqësore të tij (shih rastin *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, § 210). Nuk ka asnjë provë nga apeli i saj dhe parashtresat me shkrim që ankuesja të ketë kërkuar një seancë dëgjimore publike në apel. Gjykata ka vërejtur se ankuesja kishte mundësi të mjaftueshme për të paraqitur çështjen e saj me shkrim pranë KPA. Arsyet e ankimit kishin të bënin, në pjesën më të madhe, me çështje juridike ose më mirë çështje teknike në lidhje me vlerësimin e pasurive që mund të trajtoheshin në mënyrë të kënaqshme vetëm në bazë të shkresave të çështjes.

Gjykata ka arritur në përfundimin se përpara KPK-së, i cili ishte i pavarur dhe i paanshëm, ishte zhvilluar një seancë publike dhe se kërkuuesja nuk kishte kërkuar një seancë dëgjimore përpara Kolegjit të Apelimit, i cili, gjithsesi, kishte dhënë arsye të mjaftueshme për mosmbajtjen e një seance publike. Për shkak të natyrës së procedurave në apel, gjatë të cilave kërkuuesja kishte patur mundësi të plota të paraqiste argumentet e saj me shkrim, dhe faktin se nuk kishte qenë e nevojshme të pyetej ndonjë dëshmitar ose të merrej ndonjë provë tjetër gojarisht, mbajtja e një seance publike nuk kishte qenë e domosdoshme. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mungesën e një dëgjimi publik para KPA.

Në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike, për mungesë të periudhës së parashkrimit. Gjykata vërejtë se, duke pasur parasysh procesin e vlerësimit të pasurive personale ose familjare të grumbulluara gjatë jetës profesionale të gjyqtarit, rrethanat lehtësuese të parashikuara në ligjin për rivlerësimin, dështimi i ankueses për të paraqitur

dokumente mbështetëse që vërtetojnë pamundësinë objektive për të demonstruar ligjshmërinë e të ardhurave të partnerit të saj dhe mosveprimi i saj për të zbuluar aktivin në kohën përkatëse që e kishte fituar, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me pretendimin e shkeljes së parimit të sigurisë juridike.

6. Përfundime

Tashmë është e sigurtë që procedurat disiplinore duhet të përmbushin kërkesat e nenit 6 (1) për një seancë të drejtë dhe nevoja për drejtësi në kryerjen e procedurave të tilla tashmë reflektohet në të rekomandimet dhe instrumentet ndërkombëtare në fushën e procedurave disiplinore.

Edhe procedurat e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë nuk bëjnë përjashtim nga ky konkluzion. Elementet kryesore të parimit të procesit të rregullt janë parimi i i pavarësisë së organit, parimi i paanshmërisë, parimi i gjykatës së krijuar me ligj, e drejta e subjekteve për t'u njohur me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura, e drejta për t'u mbrojtur përpara se të merret një vendim, duke pasur mundësinë për t'u mbrojtur vetë ose me avokat, të drejtën për të kërkuar prova dhe paraqitur vetë të tilla përpara organit të rivlerësimit, e drejta për t'u dëgjuar në një seancë publike, e drejta për të pasur një vendim të arsyetuar, dhe e drejta për t'u ankuar përpara një gjykate me juridiksion të plotë mbi faktin, provat dhe ligjin janë elementet e një procesi të rregullt.

Gjykata Evropiane nuk vërejtí cënim të parimit «nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj ». Gjykata çmoi se organet e rivlerësimit ishin ngritur dhe formuar në mënyrë të ligjshme dhe kishin qenë « gjykatë e krijuar me ligj », për shkak të bazës ligjore mjaftueshmërisht të qartë (duke iu referuar Kushtetutës dhe Ligjit të rivlerësimit) që parashikonin ngritjen e KPK-së dhe të Kolegjit të Apelimit, për shkak të juridiksionit dhe kompetencave të tyre ekskluzive për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve.

Mospërzgjedhja e anëtarëve të organeve të rivlerësimit nga trupa e gjyqtarëve aktualë ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, në veçanti në përpjekje për të shmangur ndonjë konflikt të interesit dhe për të garantuar besimin e publikut në këtë proces. Kohëzgjatja e mandatit të tyre ishte e pranueshme duke patur parasysh natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit. Gjykata arriti në përfundimin që legjislacioni i brendshëm kishte parashikuar garanci ndaj palëvizshmërisë së tyre si dhe për funksionimin e duhur të organeve të rivlerësimit.

Përsa i përket paanshmërisë, Gjykata vuri re se nuk kishte dyzim të roleve të KPK-së: detyrimi ligjor për të filluar hetimin ishte automatik dhe nuk kushtëzohej nga ngritja e ndonjë « akuze » për shkelje disiplinore ndaj kërkueses; gjetjet paraprake të tij ishin bazuar mbi informacionin që ndodhej në dosje kur ende nuk ishin marrë parasysh argumentet mbrojtëse të kërkueses; dhe ai e kishte marrë vendimin mbi përgjegjësinë disiplinore të kërkueses mbi bazën e të gjitha parashtrimeve që ishin bërë, duke përfshirë provat që kishte paraqitur dhe argumentet që ajo kishte ngritur në seancë publike.

Dhënia e një organi disiplinor profesional, në krahasim me një gjykatë, e pushtetit për të përcaktuar nëse një shkelje disiplinore është kryer apo jo dhe më pas dhënia e një pushteti për të vendosur një sanksion nëse vërtetohet se është kryer një shkelje disiplinore, nuk është në vetvete, në kundërshtim me kërkesat e nenit 6/1. Megjithatë, organi disiplinor, ose duhet të përmbushë vetë kërkesat e nenit 6/1 ose vendimet e tij duhet t'i nënshtrohen ankimit pasues nga një organ gjyqësor që (a) ka juridiksion të plotë ose siguron shqyrtim të mjaftueshëm mbi çështjen që organi ka përcaktuar dhe (b) ofron garancitë të cilat pritet të respektohen nga kjo dispozitë e Konventës Evropiane.

Sa i përket të drejtave që përbëjnë një proces të rregullt në procedurat e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, vend të veçantë zë e drejta për personin që i nënshtrohet procedimit disiplinor për të njohur çështjen që ai duhet të mbrohet. Kjo do të bëjë të domosdoshme, në veçanti, njohjen e dokumenteve mbi të cilat bazohen gjetjet kundër tij. Procedimet do të duhet

që të zhvillohen nga një trupë disiplinore me cilësi integriteti dhe të jetë e kualifikuar në mënyrë të përshtatshme. Personi që i nënshtrohet procedurës rivlerësuese duhet të ketë të drejtën e një seance dëgjimore, një në të cilën ai të ketë mundësi të ushtrojë një mbrojtje efektive dhe të paraqesë çdo provë ose dëshmitar që do të dëshmojnë para organit të rivlerësimit.

Analiza e vendimmarrjes së parë të Gjykatës Evropiane e ka konsideruar të drejtë e të rregullt procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

BIBLIOGRAFI

- ANASTASI, Aurela. (2019) ‘Koment i nenit 179/b’ në *Komentar mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë*: Arta Vorpsi, Aurela Anastasi, Gent Ibrahim, Sokol Berberi, Sokol Sadushi (editoret). (Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Instituti për Studimet Publike e Ligjore.
- CCJE, ‘Opinion No 1 (2001) on Standards Concerning the Independence of the Judiciary and the Irremovability of Judges’ (2010) CCJE (2001) OP N°1
- CCEJ, ‘Opinion No 2 (2001) on the Funding and Management of Courts with reference to the Efficiency of the Judiciary and to Article 6 of the European Convention on Human Rights’ (2001) CCJE (2001) OP N°2
- CCEJ, ‘Opinion No 6 (2004) on Fair Trial within a Reasonable Time and judge’s role in trials taking into account alternative means of dispute settlement’ (2004) CCJE (2004) OP N°6
- CCEJ, ‘Opinion no.10(2007) on the Council for the Judiciary at the service of society’ (2007) CCJE (2007) OP N°10
- CCEJ, ‘Opinion no.11(2008) on on the quality of judicial decisions’ (2008) CCJE (2008) OP N°11
- CCJE, ‘Magna Carta of Judges: Fundamental Principles’ CCJE (2010)3 Final Committee of Ministers, ‘Recommendation No R(94) 12 of Committee of Ministers to Member States on the independence, efficiency and role of judges’ (1994)
[https://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykkkanunteklifi/recR\(94\)12e.pdf](https://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykkkanunteklifi/recR(94)12e.pdf)
- Council of Europe, ‘European Charter on the Statute for Judges’ (1998) DAJ/DOC (98) 23.

KPA, Vendimi nr. 1, datë 31.01.2019 <<http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.-1-date-31.01.2019-subjekti-Artan-Lazaj-vendimi-mendimi-i-pakic%C3%ABs-per-publikim.pdf>> aksesuar më 1 Nëntor 2022

KPA, Vendimi nr. 2, datë 04.02.2019 <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.-2-date-04.02.2019-subjekti-i-rivleresimit-Artan-Zeneli_web-i-fundit.pdf> aksesuar më 1 Nëntor 2022

KPK, ‘Hapat procedurale të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit’ <<http://kpk.al/wp-content/uploads/2017/11/Hapat-Procedurale-te-Unifikuar.pdf>> aksesuar më 6 Nëntor 2022

Komiteti i Ministrave, ‘Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë’. <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5465AA99-CC26-4DF5-A0CC-71859B61FED3.pdf>

BIANKU, Ledi. (2019) *E drejta për një proces të drejtë*, Tiranë

Ligji 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar (Kushtetuta e Shqipërisë)

Venice Commission, ‘Draft interim opinion on the Draft Constitutional Amendments on the Judiciary of Albania’ (Opinion No. 824/2015) CDL(2015)052

Venice Commission, ‘Opinion on the Law on Disciplinary Responsibility and Disciplinary Prosecution of Judges of Common Courts of Georgia’ (adopted by the Venice Commission at its 70th Plenary Session, 16-17 March, 2007) CDL-AD (2007)009



UNIVERSITY COLLEGE
BEDER

Address

"Jordan Misja" St, Tirana - Albania
e-mail: bjh@beder.edu.al , www.beder.edu.al

